




ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE

Bankieri

Botim i Shoqatës Shqiptare të Bankave

Nr. 15, Prill 2015

ISSN 2225-2959



LIKUIDITETI I TEPËRT dhe menaxhimi i tij



ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE

Partneritet me Shoqatën Europiane të Trajnimit për Shërbime Bankare dhe Financiare (EBTN)

AAB, u bë anëtar i asociuar i Shoqatës Europiane të Trajnimit për Shërbime Bankare dhe Financiare (EBTN). EBNT është zëri i bashkuar i ofruesve të trajnimit dhe arsimit në industrinë bankare.

**MARS
2015**

**MAJ
2015**

Pritet të publikohet Raporti për përgjegjshmërinë Sociale të Bankave 2014

Edicion special i cili do të përfshijë iniciativat e bankave anëtare në kuadër të të Përgjegjshmërisë Sociale të Korporatës, gjatë vitit 2014.

Trajnimet në vijim

Maj 2015 - Negocim në shitje; Menaxhim i Kohës,
Lidershipi Strategjik dhe Qeverisja Efektive
Qershor 2015- Menaxhim i Riskut Operacional,
Menaxhimim Projekti

**MAJ -
QERSHOR
2015**

**QERSHOR
2015**

Konferencë në bashkëpunim me Institutin e Auditorëve të Brendshëm

Instituti i Shqiptar i Auditorëve të Brendshëm (AIIA), në bashkëpunim me Shoqatën Shqiptare të Bankave do të organizojnë në qershor Forumin e parë të Auditorëve të Brendshëm.



LIKUIDITETI I TEPËRT dhe menaxhimi i tij

Bankieri është publikimi zyrtar i Shoqatës Shqiptare të Bankave i cili i dedikohet kryesisht sektorit bankar shqiptar. **Bankieri** i jep lexuesit një informacion të vlefshëm mbi arritjet e industrisë në përgjithësi dhe të bankave tregtare në veçanti.

SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE
Rr. Ibrahim Rugova,
SKY TOWER, 9/3, Tiranë
Tel: +355 4 2280371/2
Fax: +355 4 2280 359
E-mail: bankieri@aab-al.org
www.aab.al

Bankieri
Nr.15, Prill 2015
Botim i Shoqatës Shqiptare të Bankave

Mesazh i Kryetarit të ri të AAB-së
Christian CANACARIS

Editorial
Deti i likuiditetit nuk është Deti i Qetësisë
Elvin MEKA

Tema e ditës
Likuiditeti i tepërt në sistemin bankar shqiptar
Sfida e menaxhimit të tij
Jola DIMA
Suela TOTOKOÇI
Oreksi për rrezik dhe likuiditeti
Arjan KADAREJA

Intervista
Gent Sejko, Guvernatori i ri i Bankës së Shqipërisë
Gent SEJKO

Sistemi Bankar
Huadhënia në monedhë të huaj
Rrezik i lartë apo investim i kushtëzuar për bankat?
Artiola AGALLIU
BANKINGU ose "People business"
Ermira QOSJA

Forumi i Ekspertëve
Përse jemi konservatorë për kolateralin financiar?
Iva NATHANAILI
TVSH mbi veprimtarinë financiare - Një rast për tu konsideruar
Andi PACANI

Zona e sigurisë së Informacionit
Siguria e informacionit e orientuar nga biznesi
Adriatik BALLHYSA

Këndi i Ekonomistit
Roli i politikave makroprudenciale në stabilitetin financiar
Adrian CIVICI

Përgjegjshmëria sociale
Veprimtaritë e bankave

Teknologji
Vendosja e kontaktit njerëzor në bankingun online
Nikolin KOLA

Auditori Financiar
Pagesat me kartë nëpërmjet telefonave të zgjuar
Rëndësia në tregtinë elektronike
Erion MAXHARI

AAB
AAB Aktivitete - Edukimi Financiar
AAB Trajnime

REDAKSIA:

Elvin Meka
Kryeredaktor
Eftali Peçi
Koordinatorë Produksioni
Junida Tafaj (Katroshti)
Bashkëpunëtore
Andis Rado
Fotograf
Design & Layout: PIK Creativ

Printed by: Gent-grafik

BORDI EDITORIAL:

Christian CANACARIS
Kryetar i Bordit Drejtues të AAB-së & Drejtor i Përgjithshëm i Raiffeisen Bank Shqipëri
Gazmend KADRIU
Zv./Kryetar i Bordit Drejtues të AAB-së & Drejtor i Përgjithshëm dhe Anëtar i Bordit të Union Bank

Periklis DROUGKAS
Anëtar i Bordit Drejtues të AAB-së & Drejtor i Përgjithshëm i Alpha Bank Albania

Seyhan PENCABLIGIL
Anëtar i Bordit Drejtues të AAB-së & Drejtor i Përgjithshëm i Banka Kombëtare Tregtare

Frédéric BLANC
Anëtar i Bordit Drejtues të AAB-së & Drejtor i Përgjithshëm i Societe Generale Shqipëri

Bozhidar TODOROV
Anëtar i Bordit Drejtues të AAB-së & Drejtor i Përgjithshëm i Fibank Shqipëri

Endrita XHAFERAJ
Sekretare e Përgjithshme, Shoqata Shqiptare e Bankave

Hysen ÇELA
Kryetar i Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar

Adrian CIVICI
President i Universitetit European të Tiranës

Spiro BRUMBULLI
Drejtor i kabinetit të Ministrisë të Financave

Enkeleda SHEHI
Drejtoreshë Ekzekutive e Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare

KREDI KONSUMATORE

nesër

KREDI KONSUMATORE NË VETËM



Apliko sot, merre nesër!

 (04) 454 1083



NBG Bank
Tradicionalisht e besueshme



Mesazh i Kryetarit të ri të AAB-së

I dashur lexues,

Është një kënaqësi e madhe për mua të ndaj me ju mesazhin tim të parë si Kryetar i Shoqatës Shqiptare të Bankave. Personalisht mendoj se ne jemi të gjithë partnerë dhe synimi im është sigurimi i një bashkëpunimi të ngushtë, të frytshëm dhe transparent me të gjithë grupet e interesit. Tashmë jetoj prej më shumë se 10 vitesh në Shqipëri dhe mendoj se ndajmë të njëjtin vizion për zhvillimet e sistemit bankar: ne jemi padyshim motori i rritjes ekonomike dhe duhet të sillemi si të tillë. Komuniteti i biznesit, Qeveria, Banka e Shqipërisë dhe institucione të tjera të rëndësishme, si aktorët kryesorë të skenës së madhe, janë në të njëjtën gjatësi vale me sistemin bankar. Jemi të lidhur pazgjidhshmërisht me njëri tjetrin, si në suksese ashtu dhe në dështime, e kështu besoj fort se partneriteti i hapur dhe i sigurtë, që përbën idenë time për të siguruar një histori suksesi për ekonominë shqiptare dhe këtë vend, është ideja jonë dhe një qëllim që duhet ta arrijmë së bashku.

Në këtë kuadër, dëshiroj të theksoj se do të vazhdoj të lojoj, përmes AAB-së, për të drejtat e sistemit bankar, për përmirësimin e mjedisit, rregullave dhe procedurave që ndjekim gjatë veprimtarisë tonë, për vendime gjyqësore më të drejta, për më shumë qasje proaktive nga të gjithë grupet e interesit. Unë besoj se ne duhet të vazhdojmë të fokusohemi në promovimin e sektorit bankar, ekonomisë shqiptare, dhe vetë Shqipërisë. Ne jemi të fortë, të mirë-kapitalizuar, likuid e shumë të mirë-rregulluar dhe mendoj se do vazhdojë të rritemi, vetëm duke mbështetur gjithnjë e më shumë ekonominë, duke financuar projekte të mira, me një ndikim të drejtpërdrejtë në rritjen e PB-së dhe punësimit, duke zhvilluar dhe paraqitur në treg produkte dhe shërbime bankare më moderne dhe duke konkurruar në mënyrë të drejtë.

Përputhshmëria me rregullat dhe procedurat e BE-së është një tjetër pikë e shumë e rëndësishme e kohëve të fundit. Unë mendoj se ne duhet të jemi të matur dhe të kujdesshëm, me qëllim që të zbusim efektet negative. Sot ndihem më optimist kur shoh se, për herë të parë pas një kohe të gjatë, huat me probleme po tregojnë një prirje rënëse. Kjo është një shenjë e mirë për zhvillimet ekonomike të vendit.

E fundit, por jo për nga rëndësia, do të dëshiroja të falenderoja paraardhësin tim, z. Pencabligil, për përpjekjet e tij për drejtimin e AAB-së gjatë viteve të fundit.

*Sinqerisht,
Christian Canacaris*



Ne mbështesim prodhimin vendas, një investim që ia vlen!



Kredia Eko-Agro

- ◆ Përmirëso cilësinë e produkteve
- ◆ Rrit produktivitetin
- ◆ Redukto shpenzimet mujore





nga Prof. Asoc. Dr. Elvin MEKA¹
Kryeredaktor

Rreziku i likuiditetit është një ndër rreziqet më të monitoruara dhe menaxhuar siç duhet në industrinë bankare, e kjo për arsyen e thjeshtë të materializimit tejet të shpejtë të tij dhe efekteve shkatërruese që ai ka mbi biznesin dhe sektorin bankar. Rrjedhimisht, bankat bëjnë përpjekje të mëdha, duke përdorur instrumente apo strategji të ndryshme, përveç kërkesave rregullatore dhe të detyrueshme, për të siguruar që niveli i likuiditetit në to të mos bjerë poshtë disa niveleve minimale të përcaktuara. Një prej këtyre instrumenteve është dhe likuiditeti i tepërt, d.m.th. sasia e likuiditetit që bankat mbajnë, përtej rezervës së detyrueshme, që mbahet në mënyrë të detyrueshme pranë bankës qendrore. Por ndërkohë që bankat përpiqen të shmangin problemet e mundshme të likuiditetit dhe rrezikun e financimit, një tjetër çështje shpaloset përpara tyre, kur likuiditeti i tepërt e tejkalon kufirin e pragut të cak-

Deti i likuiditetit nuk është Deti i Qetësisë

|| Bankat në Shqipëri e kanë realizuar tashmë me sukses procesin e progresit të shpejtë drejt zhvillimit të një sektori bankar modern dhe kanë mbërritur në stacionin e ndërrimit të linjave, pikërisht aty ku duhet të fillojë puna për ndërtimin e rrugës së thellimit financiar.

tuar parandalues, duke i “nxjerrë” ato në detin e likuiditetit. Kjo i ngjan situatës që mbizotëron aktualisht në sistemin bankar shqiptar, ku likuiditeti është i kudondodhur. Ekzistojnë disa arsye që e kanë krijuar akumulimin e një sasive të tillë likuiditeti të tepërt, si: tkurrja e veprimtarisë ekonomike dhe investuese të bizneseve, rënia respektive e kërkesës për hua bankare, si dhe alternativat e kufizuara të investimit në sistemin financiar vendas, në një kohë kur depozitat vazhdojnë të rriten, edhe pse me ritme modeste.

Në kuadër të kushteve aktuale të tregut ndërkombëtar, rajonal dhe atij shqiptar nuk ka gjasa që bankat do të fillojnë ta përdorin këtë likuiditet të tepërt për të zgjeruar dukshëm huadhënien, pasi ato janë mjaftueshëm të arsyeshme e të kujdesshme, sa të mos i shpërdorojnë fondet e besuara te to. Nga ana tjetër, ato janë të kufizuara nga kuadri rregullator në fuqi që të kenë ekspozime të mëdha në letrat me vlerë të qeverisë shqiptare apo dhe me bankat mëma, apo me korrespondentët e tyre ndërkombëtarë. Kështu, në fund të ditës, bankat e gjejnë veten brenda një rrethi vicioz të përsosur. Në rolin e tyre si një njësi normale biznesi, ato duhet të prodhojnë fitim, e nisur nga kjo, bankat do përpiqen të ulin koston e fondeve. Kjo është ajo çka po ndodh në të vërtetë këtu, pasi depozitat me afat po zvogëlohen, ndërkohë që llogaritë rrjedhëse janë në rritje. Por depozitat me kosto të ulët thjesht i ndihmojnë bankat të mbajnë

marzhin neto të interesit të paprekur, ndërkohë që prania e skemave të investimeve kolektive me kthime më të larta e bëjnë tërheqjen e depozitave me kosto të ulët një përpjekje të mundimshme për bankat, në një periudhë afatgjatë.

Bankat po lundrojnë tashmë në Detin e likuiditetit, i cili për fat të keq nuk mund të quhet Deti i Qetësisë. Në këto kushte, duhet të merren parasysh disa zgjidhje jo-tradicionale, si: mekanizmat qeveritarë për rritjen e besueshmërisë së huamarrësit, zhvillimi gradual i tregut të letrave me vlerë, e ndoshta dhe emetimi i letrave me vlerë nga ana e bankës qendrore. Bankat në Shqipëri e kanë realizuar tashmë me sukses procesin e progresit të shpejtë drejt zhvillimit të një sektori bankar modern dhe kanë mbërritur në stacionin e ndërrimit të linjave, pikërisht aty ku duhet të fillojë puna për ndërtimin e rrugës së thellimit financiar. Megjithatë, bankat nuk mund të lihen të vetme në këtë sipërmarrje strategjike dhe tani është koha që qeveria dhe rregullatorët e tregut financiar të bëjnë pjesën e tyre. Bankat janë dhe do të jenë këtu për të mbështetur ekonominë, bizneset dhe individët, por duke vepruar në interesin më të mirë të aksionarëve të tyre, në një mënyrë të kujdesshme, ndërkohë që e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në përputhje të plotë me ligjet dhe rregulloret në fuqi!

¹ Zv.Dekan & Përgjegjës i Departamentit të Financës, UET

Teprica e likuiditetit në treg mund të gjykohej fillimisht duke parë raportin Hua/Depozita të sistemit bankar si dhe veçanërisht ecurinë e këtij raporti gjatë vitit të fundit (31 dhjetor 2013 – 31 dhjetor 2014). Vlera aktuale e ulët, ashtu si prirja rënëse e këtij raporti, tregon në mënyrë të qartë likuiditetin e tepërt në treg, që manifestohet me një rritje të depozitave të klientëve, të pashoqëruar në të njëjtën masë nga rritja e huave. Nëse do të shkonim pak më thellë dhe të vlerësojmë të njëjtin raport, por tashmë të ndarë për monedhë vendase dhe atë të huaj, do të kishim një situatë më kritike për monedhën e huaj.

Siç u përmend dhe më lart, likuiditeti i tepërt përcaktohet nga ecuria e dy faktorëve: nga rritja e portofolit të depozitave si dhe mosrritja, apo rënia e portofolit të huadhënies. Nëse do të donim të njiheshim me faktorët që ndikojnë në ecurinë e secilit prej tyre do të mund të përmendim:

Rritja e depozitave. Pavarësisht normave të interesit që sot janë në nivelet më të ulëta historike, në veçanti ato në EURO (gati zero), si pasojë e politikës monetare dhe normave të interesit të përcaktuara në vijim nga Banka Qendrore Evropiane, përsëri ka një prirje në rritje të depozitave, që mund të ketë ardhur si rezultat i disa elementëve, nga të cilat mund të përmenden:

- treguesi në rënie i besimit të konsumatorëve, i cili shprehet në prirjen e tyre kundrejt reduktimit të shpenzimeve dhe rritjes së kursimeve,
- shlyerja nga ana e qeverisë, e detyrimeve të prapambetura ndaj bizneseve dhe palëve të treta, gjatë pjesës së dytë të vitit 2014,
- rritja e besimit ndaj sistemit bankar, si dhe një prirje në rritje (ndonëse me hapa të ngadalta) e formalizimit të ekonomisë vendase (nga cash në jo-cash),
- transferimi i kursimeve të emigrantëve nga Greqia në Shqipëri.

Mos-rritja, apo rënia e portofolit të huadhënies. Në ecurinë e këtij faktori kanë ndikuar, ndër të tjera:

- kërkesa e dobët për hua nga ana e klientëve, qofshin këta biznese apo individë, që lidhet në mënyrë të



Zj. Jola DIMA

Drejtuese e Divizionit të Menaxhimit të Riskut

INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA



Zj. Suela TOTOKOÇI

Drejtuese e Divizionit të Tregut Financiar dhe të Kapitalit

INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA

Likuiditeti i tepërt në sistemin bankar shqiptar

Sfida e menaxhimit të tij



Nëse bankat likuiditetin e mbledhur nga depozituesit nuk arrijnë ta investojnë në hua në tregun e brendshëm, ndërkohë që investimet alternative janë më të kufizuara se më parë, qoftë si rezultat i kërkesave shtrënguese nga autoritetet mbikëqyrëse, apo dhe normave të ulëta ose negative në tregun ndërkombëtar, atëherë e gjithë kjo do ndikojë negativisht në ecurinë e tyre.



- drejtëpërdrejtë me ritmet e ulëta të rritjes ekonomike, si një ndër elementët me domethënës të dobësisë së këtij faktori,
- përqasja përgjithësisht më ortodokse nga ana e bankave në dhënien e huave, si pasojë e ndërgjegjësimit për nevojën e zbatimit të standardeve të duhura të huadhënies, veçanërisht për bizneset, si rezultat i një eksperience në menaxhimin e nivelit relativisht të lartë të huave

- me probleme. Mungesa e zbatimit të zgjeruar të standardeve të kontabilitetit, auditimi i pasqyrave financiare, situata në rregullim e sipër e sektorëve të ndryshëm, e licencave specifike si dhe problemet me pasuritë e paluajshme vështirësojnë vendim-marrjen e shpejtë dhe të qartë në lidhje me huadhënien.
- korrigjimi jodomethënës i nivelit të huave të këqija të sistemit bankar,



pavarësisht masave ligjore të marra dhe pagesave të detyrimeve të prapambetura nga ana e qeverisë. Një faktor që vështirëson rikuperimin e tyre janë edhe masat e marra nga entet shtetërore për grumbullimin e tatimeve, ndaj të njëjtëve debitorë.

d) rënia e besimit të konsumatorit, si dhe çmimet e larta të pasurive të paluajtshme, kanë dhënë efekt në uljen e kërkesës për blerje banesash, duke u pasqyruar kështu në rënien e kërkesës për hua për shtëpi.

Megjithatë, një faktor i tretë, përveç rritjes së depozitave dhe mos rritjes së mjaftueshme të huave mund të jetë dhe **nevoja e bankave për të rritur kapitalin**, si rrjedhojë e nivelit të lartë të huave me probleme, apo kuadrit rregullator shtrëngues, faktor ky që është përkthyer në likuiditet të shtuar në sistemin bankar.

Ekzistenca e një shkalle të lartë likuiditeti, pavarësisht efekteve pozitive që në parim çojnë në stimulimin e huadhënies me norma konkurruese, ka efektet e veta negative, duke qenë se krijon një trysni të lartë me pasoja jo-pozitive në përfitueshmërinë dhe në veprimtarinë e bankave si ndërmjetës financiarë. Një likuiditet i tillë vjen më shumë i theksuar në monedhë të huaj, ku skenari i normave të interesit në tregjet ndërkombëtare është tërësisht jo i favorshëm, lidhur me investimet alternative të huadhënies. Ndërkohë, investimet alternative në monedhën vendase vazhdojnë të

jenë të mundësuar nga blerja e letrave me vlerë, të emetuara nga qeveria shqiptare, pavarësisht kufizimeve të veta si rrjedhojë e kufijve të brendshme të secilës bankë, që synon të mbajë nën kontroll ekspozimin kundrejt qeverisë shqiptare, në kuadër të menaxhimit të rreziqeve të përqendrimit. Megjithatë, mund të pohohet që edhe kjo dritare po fillon të mbyllet, për sa kohë qeveria planifikon ulje të borxhit të brendshëm.

Me pak fjalë, nëse bankat likuiditetin e mbledhur nga depozituesit nuk arrijnë ta investojnë në hua në tregun e brendshëm, ndërkohë që investimet alternative janë më të kufizuara se më parë, qoftë si rezultat i kërkesave shtrënguese nga autoritetet mbikëqyrëse, apo dhe normave të ulëta ose negative në tregun ndërkombëtar, atëherë e gjithë kjo do ndikojë negativisht në ecurinë e tyre.

Siç u përmend edhe më lart, kërkesa e brendshme për hua vazhdon të mbetet e dobët në përgjithësi, e në monedhë të huaj në veçanti. Me ndryshimet më të fundit në kuadrin e brendshëm rregullator, një hua e dhënë në monedhë të huaj kërkon mbullim në një masë më të lartë me kapital sesa një hua në monedhë vendase, gjë që do t'i vendoste bankat në një pozitë të vështirë nëse do të ishin shumë afër kufirit të detyruar të mjaftueshmërisë së kapitalit. Nga ana tjetër, po kuadri rregullator detyron bankat të ulin investimet e tyre afatgjata në monedhë të huaj jashtë Shqipërisë, e në veçanti me disa nga bankat mëma,

duke shtuar kështu edhe më shumë sasinë e tepërt të likuiditetit. Kjo sasi likuiditeti, që tashmë diktohet për të qëndruar brenda vendit, ka një mundësi më të ulët investimi në letra të qeverisë shqiptare, për shkak të peshës së lartë të rrezikut që ju caktohet këtyre të fundit.

Përveç kufizimeve të diktuar nga kuadri rregullator shqiptar, bankat e huaja që operojnë në Shqipëri i nënshtrohen edhe kuadrit rregullator të vendit të origjinës së bankës mëmë dhe Eurozonës, të cilat vitet e fundit janë bërë më konservatore kundrejt rrezikut dhe treguesve kryesorë të ecurisë së institucioneve financiare, mes të cilëve edhe treguesve të likuiditetit.

Atëherë si mund të përballohet sfida e këtij likuiditeti të tepërt? Përmirësimi i treguesit të huave me probleme nga njëra anë dhe përmirësimi i kuadrit ligjor, së bashku me zbatueshmërinë nga ana tjetër, do të ndihmonte në rigjallërimin e veprimtarisë huadhënëse nga bankat, së bashku me një skenar më optimist, lidhur me rritjen ekonomike. Ndërkohë, për sa i përket depozitave, veçanërisht atyre në monedhë të huaj, ka ardhur koha që depozituesit shqiptarë t'i drejtohen investimeve alternative përveç depozitës, sjellje e cila vihet re për Lekun, ku kemi rritje të vazhdueshme të pjesëmarrjes së individëve në investimet në letrat me vlerë të qeverisë shqiptare. Në këtë mënyrë, do të pakësohej likuiditeti i tepërt në sistemin bankar, i cili momentalisht është gati i pamundur të ekuilibrohet, në një periudhë afatshkurtër, nga veprimtaria huadhënëse.



Kuadri rregullator detyron bankat të ulin investimet e tyre në monedhë të huaj jashtë Shqipërisë, e në veçanti me bankat mëma, duke shtuar kështu edhe më shumë sasinë e tepërt të likuiditetit. Kjo sasi likuiditeti, që tashmë diktohet për të qëndruar brenda vendit, ka një mundësi më të ulët investimi në letra të qeverisë shqiptare, për shkak të peshës së lartë të rrezikut që ju caktohet këtyre të fundit.





nga **Z. Arjan KADAREJA, PhD**

Pedagog

Departamenti i Administrim Biznesit
CANADIAN INSTITUTE OF
TECHNOLOGY (CIT)

FAKTET

Sipas të dhënave të përditësuara të IN-STAT-it, ekonomia shqiptare shënoi një rritje prej rreth 3.5%, gjatë periudhës 2009 - 2011 dhe shumë më poshtë se 2%, për periudhën 2012 -2014. Zhvillimet në ekonominë kombëtare, në mënyrë krejt natyrale, ishin të lidhura ngushtë me zhvillimet e tregut të huadhënies bankare në vend. Siç tregon dhe Grafiku 1, në vitin 2011, raport i huas bankare ndaj totalit të aktiveve arriti nivelin më të lartë ndonjëherë prej 47.3% , nivel ky që ra fort më pas në një pikë të ulët prej 42.6%, në vitin 2014. Për më tepër, raporti i huave të këqija bankare ndaj stokut të huave arriti një nivel shqetësues prej 11.5%, gjatë periudhës 2012 – 2014, në krahasim me rreth 6%, gjatë periudhës 2009 - 2011.


Nga ana tjetër, depozitat bankare në Lek, gjatë pjesës më të madhe të kohës, u rritën me një normë më të madhe se sa rritja nominale e PBB-së (Grafik). Këto zhvillime u shoqëruan me krijimin e një gjendje

Oreksi për rrezik dhe likuiditeti

Në vend të përpjekjeve për të stimuluar ekonominë nëpërmjet investimeve kapitale të zakonshme dhe të kushtueshme, qeveria duhet të synojë shpërndarjen në ekonominë shqiptare të fondeve private, të cilat filialet shqiptare të bankave po i mbajnë kryesisht si depozita me bankat e tyre mëmë në zonën e euros.

likuiditeti të tepërt në sistemin bankar, ku pretendimet neto të rezidentëve të huaj (kryesisht depozitat e bankave shqiptare me bankat mëmë në zonën Euro), arritën në 16.9% të totalit të aktiveve, pra në niv-

elin e tyre më të lartë të të gjithë kohëve. Kështu, ekonomia shqiptare po përballet me paradoksin e stanjacionit të huadhënies bankare, të shoqëruar me një likuiditet të tepërt në sistemin bankar.



Burimi i të dhënave: Banka e Shqipërisë dhe llogaritje të autorit

OREKSI I ULËT PËR RREZIK

Unë mendoj se likuiditeti i madh në sistemin bankar shqiptar është pasojë e një oreksi të ulët për rrezik nga ana e bankave dhe deri diku, edhe nga bizneset. Ky fakt mbështetet në të paktën dy arsye.

Së pari, ekziston një periudhë e zgjatur, që karakterizohet nga një rënie e konsiderueshme e normës mesatare faktike të kthimit nga investimet. Norma faktike e kthimit mund të matet përafërsisht nga rritja nominale e PBB-së, shumëzuar me 1 (një), minus

raportin e huave të këqija bankare ndaj totalit të huave. Gjatë periudhës 2012 - 2014, rritja nominale e PBB-së përfaqëson vetëm dy të tretat e vlerës që kishte ajo gjatë periudhës 2009 - 2011. Për më tepër, raporti i huave të këqija ndaj totalit të huave pothuajse u dyfishua gjatë periudhës së dytë, në krahasim me vlerën e saj gjatë periudhës së parë. Pra, për të dyja këto arsye, ekonomia shqiptare e ka përkeqësuar shkallën e tërheqjes së investimeve vendase, ose të huaja. Kjo shpjegon dhe rritjen e konsiderueshme të



mijeteve valutore neto të sistemit bankar, rënien e huave bankare, si përqindje e totalit të stokut të huave, kërkesën e dobët për hua nga bizneset¹ dhe, pjesërisht, edhe në rënien e investimeve të huaja të drejtpërdrejta.

Së dyti, mund të thuhet se, në Shqipëri, për shkak të shkallës së ulët të zhvillimit financiar, sipërmarrja e rrezikut nuk është thjesht e mundur për shumë individë, të cilët zotërojnë shuma të mëdha kursimesh. Kështu, zhvillimi i instrumenteve financiare dhe tregjeve, sigurisht ofron një zgjidhje për këtë problem, por siç dihet tashmë nga të gjithë, ai kërkon shumë kohë, ashtu siç tregon dhe përvoja e vendeve më të zhvilluara në rajon.

ROLI I QEVERISË

Siç sugjerojnë dhe të dhënat, ekonomia shqiptare po kalon një periudhë të zgjatur të ngadalësimit ekonomik, kur huadhënia fillon dhe bëhet më e rrezikshme dhe bankat bëhen shumë të kujdesshme në dhënie e huave. Për më tepër, ka pasiguri rreth faktit të orientimit të ekonomisë, ndërkohë që bizneset e mira bëhen nervoze rreth faktit nëse duhen të rrisin më shumë borxhin në bilanc, gjatë një periudhe pasigurie. Nga ana tjetër, siç tregon dhe Grafiku 1, ka një tepriçë likuiditeti në sistemin bankar, me të cilin bankat nuk dinë se çfarë të bëjnë.

Në këto rrethana, është zakonisht banka qendrore ajo që del në skenë dhe lehtëson politikën monetare. Ndërkohë që, banka qendrore ka realizuar shumë ulje të normave të interesit, të cilat kanë prodhuar rezultate inkurajuese për huan në Lek, ajo nuk mund të ushtrojë ndonjë ndikim të rëndësishëm në tregun e huave të akorduara në euro.

Ajo çfarë i ka mbetur qeverisë është që të ndërmarrë një politike fiskale kundërcik-

like. Konkretisht, qeveria mund të marrë hua, në emër të qytetarëve, gjatë periudhës së ngadalësimit ekonomik dhe të paguajnë përsëri në të ardhmen, gjatë periudhës së zgjerimit të ekonomisë. Zakonisht, qeveritë konsiderohen se mbartin pak rrezik e kështu që mund të huazojnë fonde, në çdo kohë, me kosto arsyeshëm të ulët. Për fat të keq, situata aktuale në Shqipëri është më shumë e ndërlikuar se kaq.



Duket të jetë shumë më e lehtë joshja e parave të origjinuara nga Shqipëria, për të financuar projektet e investimeve në Shqipëri, se sa tërheqja e investime të tjera të huaja të drejtpërdrejta, në një mjedis gjithnjë e më konkurrues.



Në kuadër të marrëveshjes me FMN-në, politika fiskale në Shqipëri është në rrugën e konsolidimit. Qeveria planifikon që, deri në fund të 2015, borxhi publik në raport me PBB-në të shënojë rënie. Kjo do të shënonte rënien e parë, që prej vitit 2010. Ndërsa një zgjidhje e tillë është e mirë në afat të mesëm dhe të gjatë, mendoj se duhet t'i kushtohet gjithashtu vëmendje dhe zhvillimeve afatshkurtra.

Njëra prej zgjidhjeve është që të lihet tregu i kapitaleve të punojë. Perceptimi im është se zgjidhja nëpërmjet tregut mund të kërkojë shumë kohë për t'u materializuar,

ashtu siç tregon dhe përvoja e kohëve të fundit. Një mundësi tjetër është ndërhyrja nga ana e qeverisë. Pyetja që shtrihet këtu është: Si mund ta bëjë këtë qeveria, duke pasur parasysh se sipërmarrja e rrezikut nëpërmjet një politike fiskale kundër ciklike është e kufizuar, në bazë të marrëveshjes aktuale me FMN-në?

Unë mendoj se, në vend të përpjekjeve për të stimuluar ekonominë nëpërmjet investimeve kapitale të zakonshme dhe të kushtueshme, qeveria duhet të synojë shpërndarjen në ekonominë shqiptare të fondeve private, të cilat filialet shqiptare të bankave po i mbajnë kryesisht si depozita me bankat e tyre mëmë në zonën e euros. Këto fonde, që arrijnë në 16,9% të aktiveve të sistemit bankar, përfaqësojnë një burim shumë të rëndësishëm të financimit për ekonominë. Duket të jetë shumë më e lehtë joshja e parave të origjinuara nga Shqipëria, për të financuar projektet e investimeve në Shqipëri, se sa tërheqja e investime të tjera të huaja të drejtpërdrejta, në një mjedis gjithnjë e më konkurrues. Qeveria mund të lehtësojë shpërndarjen e këtyre fondeve, duke marrë përsipër një pjesë të kufizuar të rrezikut. Marrja përsipër e rrezikut mund të synojë sektorë të rëndësishëm të ekonomisë, nëpërmjet formës së partneritetit publik-privat, garancive, subvencioneve, rregullave dhe rregulloreve të reja, zbatimin më të mirë të ligjit, etj. Së fundi, qeveria dhe marrja përsipër e një rreziku të kufizuar mund të çojë në rritjen e normën e pritshme të kthimit nga investimet në ekonominë shqiptare, që në gjykimin tim është faktori kryesor për oreksin e ulët të sipërmarrjes së rrezikut.

PËRFUNDIM

Në përfundim, mendoj se ekzistojnë disa fakte që tregojnë se, në rrethanat aktuale, rreziku i biznesit nga ana e sektorit privat nuk është sipërmarrje e vlefshme. Kjo sjellje ka të ngjarë të zgjasë periudhën, edhe kështu të gjatë, të rritjes së ulët ekonomike. Gjykoj se situata kërkon angazhimin e qeverisë nëpërmjet një strategjie të sipërmarrjes së kontrolluar të rrezikut, me qëllim lehtësimin e shpërndarjen në ekonominë shqiptare të fondeve të konsiderueshme me origjinë shqiptare, që mbahen kryesisht si depozita nga filialet shqiptare të bankave, pranë bankave të tyre mëmë në zonën e euros. Strategjia ka potencial për të qenë e suksesshme, pasi duket se është më e lehtë për qeverinë shqiptare të tërheqë paratë e origjinuara në Shqipëri, për të financuar projektet e investimeve në Shqipëri, se sa të përpiqet të tërheqë investime shtesë të drejtpërdrejta të huaja, në një mjedis shumë konkurrues.

¹ TENDENCAT NË KREDITIM nga Eriona Suljoti and Sofika Note, Departamenti i Politikës Monetare, Banka e Shqipërisë, Janar 2015.



Fitoni çdo sfidë!



Raiffeisen
BANK

www.raiffeisen.al



Z. Gent SEJKO

Guvernator
BANKA E SHQIPERISË

BANKIERI:

Së pari ju urojmë suksese në detyrën e re të Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë. Duke u rikthyer në Bankën e Shqipërisë si e gjeni sot atë nga pikëpamja institucionale, profesionale dhe njerëzore?

Duke ju falënderuar për urimin më lejoni të shpreh konsideratën time për revistën BANKIERI. Në përgjithësi, forume të tilla të analizës dhe informimit mbi zhvillimet ekonomike dhe financiare në vend dhe më gjerë, i vlerësoj të dobishme dhe të domosdoshme.

Duke ju kthyer pyetjes suaj, rikthimi në Bankën e Shqipërisë si drejtues i saj, më jep një kënaqësi të veçantë, veçanërisht pas eksperiencave të fundit si administrator në sektorin bankar. Personalisht e vlerësoj si një kulmim të karrierës sime profesionale, ndërkohë që padyshim e shoh edhe si një përgjegjësi të madhe publike, të cilën duhet ta përmbush me sukses. Në historikun e veprimtarisë së saj, Banka e Shqipërisë është një institucion mjaft i vlerësuar. Në të gjitha

Gent Sejko, Guvernatori i ri i Bankës së Shqipërisë

█ █ Duke konsideruar kushtet e tregut të brendshëm dhe specifikat e ekonomisë sonë, objektivi ynë do të jetë përafrimi i vazhdueshëm me kuadrin politik dhe instrumental të bankave anëtare të sistemit të bankave qendrore të Bashkimit Evropian.

raportet e institucioneve ndërkombëtare do të gjeni të shprehur vlerësime për punën e saj, të cilat kanë një emërues të përbashkët: profesionalizmi i stafit. Është privilegj të punosh me një staf të tillë dhe unë kam e shprehur këtë gjë që ditën e parë të punës time si Guvernator. Në të njëjtën kohë, më lejoni të jem dhe i sinqertë, është emocion i veçantë të kthehesh në një mjedis të tillë, mes kolegësh e miqsh të mirë.

BANKIERI:

Duke qenë se emërimi dhe miratimi i Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë ka kaluar nëpërmjet një procesi dhe debati kompleks, por gjithsesi konsensual, a e shikoni këtë post si një sfidë personale?

Ngjarjet e ndodhura në gjysmën e dytë të vitit të kaluar, kanë dëmtuar reputacionin dhe besimin e publikut ndaj institucionit. Nuk kishte si të ndodhte ndryshe. Për këtë qëllim, vlerësoj si shprehje të lartë përgjegjshmërie konsensusin politik në mbështetjen e kandidaturës sime për drejtimin e institucionit. Ky konsensus shumëpalësh është sa inkurajues, po aq edhe sfidues. Bëhet fjalë për institucionin që garanton soliditetin e dy prej kolonave më të rëndësishme për çdo ekonomi: ekuilibrin makroekonomik dhe stabilitetin financiar të vendit; bëhet fjalë për bankën tonë qendrore: Bankën e Shqipërisë.

Shpreh bindjen se me energjinë pozitive që çliron çdo ndryshim, do të rikthejmë shumë shpejt reputacionin e Bankës së Shqipërisë në nivelin e merituar. Kjo është sfida ime e parë, me të cilën, së bashku me

Këshillin Mbikëqyrës dhe stafin e Bankës së Shqipërisë, dua ta përballem. Sfidë ime natyrshëm mbart aspiratën e të qenit në nivel me pritshmëritë e publikut, jo vetëm për rikthimin e besimit, por më tepër, për të çuar përpara një institucion që ka kontribut të prekshëm e real për të gjithë qytetarët.

BANKIERI:

Nisur nga situata dhe momenti aktual që po kalon sistemi bankar dhe ekonomia kombëtare, a mund të përshkruani se cilat janë sfidat dhe çështjet kryesore, që ju gjykoni se kanë përparësi absolute për Bankën e Shqipërisë?

Vlerësoj se sfidat, me të cilat duhet të përballemi janë të materializuara para së gjithash në ligjin “Për Bankën e Shqipërisë”, në orientimin e qëndrueshëm të vendit drejt integritimit evropian, si dhe në përmbushjen me sukses të angazhimeve tona institucionale që rrjedhin nga marrëveshja me FMN-në dhe BB-në.

Në mënyrë të përmbledhur po përmend disa prej tyre:

- Forcimi i kuadrit institucional të Bankës së Shqipërisë përbën një drejtim të rëndësishëm ku duhet të ndalemi. Ambicia ime është për një bankë qendrore më të thjeshtë, më të përgjegjshme dhe më të hapur. Në rast se do të kemi sukses në këto tre drejtime, atëherë besoj se do të kemi një bankë qendrore më të fortë, më të pavarur dhe sigurisht me shkallë të lartë besimi nga ana e publikut.
- Forcimi i kontrollit të brendshëm, në

mënyrë më specifike, do të jetë një nga prioritetet e para. Forcimi i rolit të tij në administrimin e rrezikut të veprimtarisë së institucionit do të jetë një garanci më shumë për parandalimin e veprimeve të papërgjegjshme dhe abuzuese në veprimtarinë ditore të institucionit. Përsosja e mëtejshme e kuadrit të politikës monetare, përfshirë edhe instrumentet përkatëse, përbën një prioritet konstant të Bankës së Shqipërisë. Duke konsideruar kushtet e tregut të brendshëm dhe specifikat e ekonomisë sonë, objektivi ynë do të jetë përafrimi i vazhdueshëm me kuadrin politik dhe instrumental të bankave anëtare të sistemit të bankave qendrore të Bashkimit Evropian.

- Përafrimi i standardeve tona të stabilitetit financiar me standardet ndërkombëtare, përfshi dhe ato të mbikëqyrjes së institucioneve financiare dhe të zbatimit të politikave makroprudenciale. Orientimi i veprimtarisë sonë në këtë fushë do të jetë me fokus nga e ardhmja, drejt identifikimit në kohë dhe trajtimit efektiv të rreziqeve të veprimtarisë bankare dhe në sistemin financiar. Në këtë drejtim, do të jemi aktiv në bashkëpunimin me sektorin bankar dhe me autoritetet e tjera në vend.
- Përmirësimi i bazës nënligjore dhe i të gjithë praktikave që rregullojnë veprimtarinë ditore të institucionit, duke nënkuptuar rishikim të pjesshëm ose të plotë të gjithë veprimtarisë që lidhet me prokurimet e mallrave dhe të shërbimeve, me rekrutimin e personelit dhe shpërblyemet e tij, me sigurinë dhe administrimin e vlerave monetare, me mirëmbajtjen dhe vënien në shfrytëzim të plotë të ndërtesave ku ushtrojmë veprimtarinë, si dhe me rritjen e sigurisë së sistemit të pagesave dhe mbikëqyrjen e tij.

BANKIERI:

Meqenëse ju vini drejtpërdrejt nga sektori bankar dhe bazuar në eksperiencën tuaj të pasur profesionale dhe drejtuese, sa do i ndihmojë kjo bankat në Shqipëri për të kapërcyer me sukses realitetet kombëtare dhe ndërkombëtare?

Sektori bankar në vend ka njohur zhvillime të rëndësishme gjatë këtyre viteve. Unë do përmendja si momente të rëndësishme privatizimin e bankave, përmirësimin e produkteve dhe të shërbimeve bankare, si edhe përballjen me pasojat e krizës ndërkombëtare të viteve 2007-2008. Dinamika e zhvillimeve në sektorin bankar është pasqyruar edhe në ndryshimin e pritshmërive të agjentëve ekonomikë për kontributin e këtij

sektori në rritjen ekonomike të vendit. Për shembull, pas privatizimeve të rëndësishme të sektorit bankar dhe hyrjes në vend të bankave të huaja, pritshmëritë kanë qenë për një zhvillim të vullshëm të veprimtarisë bankare dhe të standardeve të saj. Në pjesën më të madhe dhe të dukshme, kjo ka ndodhur realisht, nëse kemi parasysh zgjerimin e veprimtarisë bankare dhe rritjen ekonomike të vendit në vitet 2004-2007.

Nga ana tjetër, duhet të pranojmë që standardet e menaxhimit të institucioneve bankare, megjithë përmirësimin, duhet të jenë në nivele më të larta. Fokusi i bankave të huaja drejt rreziqeve të veprimtarisë, veçanërisht në periudhat e “boom”-it duhet të jetë më i madh. Janë pikërisht këto periudha kur rendja pas objektivave të fitimit shoqërohet me shfaqjen e faktorëve të rrezikut që materializohen më pas. Përballja me ndikimin e krizës financiare të vitit 2008, tregoi për sektorin bankar dhe Bankën e Shqipërisë, rëndësinë e asaj që thashë me



Në historikun e veprimtarisë së saj, Banka e Shqipërisë është një institucion mjaft i vlerësuar. Në të gjitha raportet e institucioneve ndërkombëtare do të gjeni të shprehur vlerësime për punën e saj, të cilat kanë një emërues të përbashkët: profesionalizmi i stafit. Është privilegj të punosh me një staf të tillë.



lart. Ne kemi aktualisht një sistem bankar të qëndrueshëm dhe likuid, por që për herë të parë përballet me pasojat e një cikli financiar në rënie, që përcillet nga veprimtaria e grupeve të huaja bankare zotëruese dhe ngadalësimi i rritjes ekonomike të vendit. Këto pasoja janë me të dukshme në ngadalësimin e kreditimit, në rënien e cilësisë së saj, e në përgjithësi në rënien e ndërmjetësimit financiar në ekonomi nga sektori bankar. Për çdo person që ndjek rregullisht zhvillimet ekonomike në vend dhe në botë, aq më tepër për dikë të kësaj fushe dhe që e njeh realitetin shqiptar, këto pasoja janë të pritshme. Sfida qëndron në nevojën për t'i kufizuar ato dhe për të vepruar me energji në drejtim të trajtimit të tyre efektiv. Në këtë drejtim mendoj që ecja më shpejt drejt

përafrimit me standardet ndërkombëtare, në të gjitha drejtimet që ndikojnë veprimtarinë bankare, kontribuon në trajtimin e rreziqeve aktuale dhe ruajtjen afatgjatë të qëndrueshmërisë dhe kontributit të sektorit bankar.

BANKIERI:

Si e shikoni në të ardhmen e afërt dhe të largët rolin e Bankës së Shqipërisë brenda sistemit financiar dhe ekonomisë shqiptare? A mendoni se ka ardhur koha për një rridimensionim të rolit dhe objektivave të saj?

Mbështetur në kuadrin ligjor ekzistues dhe në përvojën e funksionimit të institucionit që prej krijimit të tij, nuk besoj që ka dyshime lidhur me rolin dhe kontributin e Bankës së Shqipërisë, si banka qendrore e vendit, në zhvillimin e tij ekonomik dhe ruajtjen e qëndrueshmërisë së sektorit bankar. Unë mendoj që përgjithësisht, ky kontribut i është përgjigjur zhvillimeve dhe sfidave me të cilat është përballur ekonomia dhe sektori bankar shqiptar gjatë këtyre viteve. Sigurisht që ka vend për të përmirësuar cilësisht këtë kontribut, duke u mbështetur gjithmonë te pavarësia institucionale, profesionalizmi dhe standardet e një banke qendrore moderne. Mendoj që, edhe në vijim të trashëgimisë që po lë kriza financiare e vitit 2008 kudo në botë, dy nga drejtimet ku mund të zhvillojmë kontributin tonë institucional janë:

- a) zhvillimi i kuadrit të politikave makroprudenciale, për të qartësuar dhe forcuar rolin mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, më vete dhe në bashkërendim me autoritetet e tjera, në drejtim të parandalimit të rreziqeve në sektorin bankar dhe sistemin financiar;
- b) angazhimi më i ndjeshëm i institucionit në diskutimin e politikave të zhvillimit ekonomik në vend. Disa nga çështjet për të cilat ne jemi të interesuar në kuadër të ushtrimit me efektivitet të funksioneve tona ligjore, përfshijnë: zhvillimin e tregut financiar; masat strukturore për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të vendit; zhvillimin e kuadrit të statistikave ekonomike dhe financiare; përmirësimin e infrastrukturës ligjore lidhur me raportimin financiar, me trajtimin e marrëdhënies financiare mes debitorit e kreditorit, etj.

Unë besoj që, së bashku me anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës dhe personelin e institucionit, ne do të përmbushim me sukses të gjithë përgjegjësitë tona ligjore dhe objektivat e tjerë që lidhen me to.



nga Zj. Artiola AGALLIU

Drejtoreshë, Departamenti i Menaxhimit të Riskut
UNION BANK

Ekspozimi ndaj rrezikut të monedhës është një prej rreziqeve tipike ndaj të cilit ekspozohet sistemi bankar shqiptar. Në fakt, është folur shumë për huadhënien në monedhë të huaj dhe humbjen që mund të pësojnë huamarrësit shqiptarë nga luhatja të kursit të këmbimit, ndërkohë që, ekonomia shqiptare në tërësi është ekspozuar ndaj këtij rreziku, si rezultat i pozicionimit të vendit në hartën gjeografike të shkëmbimeve tregtare, varësisë ndaj prurjeve të emigrantëve, si dhe një sërë faktorësh të tjerë.

Rreziku i monedhës është ndikimi në rezultatit të një subjekti nga luhatja e kursit të këmbimit. Nëse p.sh.: subjekti ka marrë hua në euro ndërkohë që të ardhurat janë në lekë, atëherë në një skenar të zhvlerësimit të lek-ut, pjesa e të ardhurave në lekë do të shkojë për shlyerjen e të njëjtit këst në euro është më e madhe. Le të marrim një shembull: një individ ka marrë në janar 2007 një hua 20 vjeçare për shtëpi, me këst mujor 200 euro. Në kushtet kur të ardhurat

Huadhënia në monedhë të huaj

Rrezik i lartë apo investim i kushtëzuar për bankat?

Bankat mund të orientojnë investimet e tyre në monedhë të huaj edhe në forma të tjera jo-hua, por në këtë drejtim ato hasin vështirësi të ndryshme (përfshi çështje të lidhura me përfitueshmërinë e këtyre investimeve) si dhe kufizime nga politikat shtërnguese të rregullatorit, apo vetë bankat.


mujore të tij janë 80,000 lek, kësti i konvertuar me kursin e janarit 2007 (125 lek/euro) është 25,000 lek, ose sa 31.25 % e të ardhurave. Duke supozuar të njëjtën situatë në janar 2015, vlera e barasvlefshme e këstit në lek është 28,000 lek, ose sa 35% e të ardhurave. Luhatja e kursit të këmbimit bën që individit t'i duhet të "lërë mënjanë" më shumë nga të ardhurat e tij për të njëjtin këst. Në rastin e bizneseve situata paraqitet edhe më komplekse, për shkak të operacioneve në valutë, madhësisë së ekspozimit të shitjeve/blerjeve me klientë/furnitorë jashtë vendit etj. Cila është mbrojtja më e mirë në këtë situatë? Menaxhuesit e rrezikut japin këshilla për "përputhjen" e monedhës së arkëtimit me atë të detyrimeve.

SA I EKSPOZUAR ËSHTË SISTEMI BANKAR NDAJ LUHATJEVE TË KURSIT TË KËMBIMIT?


Ndikimi nga rreziku i monedhës është rezultat i dy faktorëve: (1) madhësisë së ekspozimit dhe (2) luhatjes së kursit të këmbimit. Madhësia e ekspozimit përgjithësisht përkon me stokun e huave të dhëna në monedhë të huaj. Në fund të vitit 2014, stoku i huas për sistemin bankar shqiptar ishte 549 miliardë lek, nga të cilat pothuaj 225 miliardë ishin në lek, 283 miliardë në euro dhe rreth 41 miliardë në dollarë amerikanë. Në terma relativë, huat në monedhën vendase përbëjnë 41% të totalit të portofolit të hua, ndërsa ato

në monedhë të huaj rreth 59%. Ekspozimi në monedhë të huaj është më i theksuar për bizneset, krahasuar me individët. Në fund të dhjetorit 2014, rreth 62% e stokut së huas dhënë bizneseve ishte në monedhë të huaj, ndërkohë që kjo peshë për individët ishte 51%. Megjithatë në nivele më të ulëta për individët, ekspozimi ndaj rrezikut të monedhës mbetet i lartë për të dy kategoritë. Nëse do të analizonim madhësinë e ekspozimit në vite, ecuria ka qenë pozitive në drejtim të reduktimit të peshës që zënë huat në monedhë të huaj. Kështu, në vitin 2011, huadhënia në monedhën vendase përbënte rreth 34% të stokut të huas, ndërsa në 2008-ën vetëm 28%. Grafiku 1 paraqet strukturën e stokut të huas në vite.


Rritja e peshës së huas në monedhën vendase përcaktohet më së shumti nga huadhënia e re dhe politika e Bankës së Shqipërisë ka luajtur rol nxitës në këtë drejtim. Kështu, huaja e re, dhënë gjatë 2014-ës, ka qenë 48% në lekë dhe 52% në monedhë të huaj, ndërkohë që këto përqindje për huadhënien e re gjatë vitit 2011 ishin respektivisht 39% dhe 61%. Politika nxitëse ka qenë më efektive në huadhënien e re për individët, krahasuar me bizneset. Përveç huadhënies së re, struktura e portofolit të huas është ndikuar, sidomos gjatë viteve të fundit nga ristrukturimet e huave ekzistuese, një pjesë e të cilave janë konvertuar në monedhën vendase.



Burimi: Banka e Shqipërisë



Burimi: Banka e Shqipërisë



Burimi: Banka e Shqipërisë

Cilët janë faktorët që ndikojnë në ruajtjen e peshës së huave në monedhë të huaj?

Faktorët që kanë ndikuar në strukturën aktuale të stokut të huas për sistemin bankar shqiptar mund të grupohen në tre kategori: (i) faktorë që lidhen me kërkesën për hua, (ii) faktorë që lidhen me burimet e fondeve për këto hua (depozitat), (iii) faktorë të tjerë që lidhen kryesisht me përfitimin ndaj normave të interesit.

Grupi i parë i faktorëve kanë qenë përcaktues në strukturën e portofolit të huas për sistemin. Meqenëse një pjesë e mirë e transakcioneve dhe investimeve tregtare kryhet në monedhë të huaj, bizneset janë të prirur drejt huamarrjes në monedhë të huaj, ndërkohë, për individët ndikim paraqet tregu i pasurive të paluajtshme. Banesat shiten dhe blihen në euro e si rrjedhim, individët kërkojnë të financohen në këtë monedhë. Pavarësisht këshillave të bankave, rreth 62% e stokut të huas për pasuri të paluajtshme dhënë individëve është në euro, duke i ekspozuar ata ndaj luhatjeve të kursit të këmbimit. Faktor tjetër i rëndësishëm janë depozitat në monedhë të huaj, të cilat në fund të vitit 2014 përbënin rreth 46% të totalit të depozitave të sistemit bankar shqiptar. Duke qenë se ky zë përbën mbi 80% të totalit të pasivit, depozitat në monedhë të huaj janë faktor përcaktues në strukturën e investimeve në krahun e aktivitetit, pra edhe të vetë portofolit të huas. Sigurisht që, bankat mund të orientojnë investimet e tyre në monedhë të huaj edhe në forma të tjera jo-hua, por në këtë drejtim ato hasin vështirësi të ndryshme (përfshi çështje të lidhura me

përfitueshmërinë e këtyre investimeve) si dhe kufizime nga politikat shtrënguese të rregullatorit, apo vetë bankat. Diskutime të ndryshme janë bërë edhe në drejtim të përparësisë që paraqesin normat e interesit. Ka një perceptim në publikun e gjerë se huadhënia në monedhë të huaj është më e lirë se ajo në lek. Megjithatë, bankat kanë bërë llogaritjet e tyre dhe ndryshimi midis normave të interesit (përfshi edhe faktorët që ndikojnë në to) nuk është aq e thjeshtë sa diferenca midis normës nominale të interesit.

LUHATJA E KURSIT TË KËMBIMIT

Sikundër u përmend, ndikimi nga rreziku i monedhës përcaktohet nga ndryshimi i faktorit të rrezikut, pra luhatja e kursit të këmbimit. Duke shqyrtuar serinë 11-vjeçare të luhatjes së kursit të këmbimit të lekut ndaj euros apo dollarit (Grafiku 2 dhe 3), vërejmë që lëvizjet gjatë 4-5 vjeçarit të fundit nuk kanë qenë të mëdha. Qendrueshmëria në këtë periudhë ka qenë më e dukshme për monedhën euro, që përbën në fakt pjesën dërrmuese të portofolit në monedhë të huaj. Konkretisht, kursi i këmbimit Lek/euro është luhatur gjatë katër 11 viteve në kufijtë 120.9 - 141.97 Lek/euro (referuar kursit mesatar mujor të publikuar nga Banka e Shqipërisë). Luhatja për periudhën 2011-shkurt 2015 ka qenë, në pjesën dërrmuese, afër nivelit 139-140 Lek/euro. Për dollarin amerikan, kursi ka qenë në nivelet 77-130 Lek/dollar dhe ecuria në vite është karakterizuar nga luhatje më të theksuara. Duke llogaritur ndryshimin mesatar vjetor në përqindje (krahasimi muaj me muaj),

monedha euro ka pasur ndryshim mesatar vjetor prej 2.5% gjatë gjithë periudhës në fjalë, ndërkohë që për dollarin ndryshimi ka qenë 8%.

MASAT RREGULLATIVE PËR MENAXHIMIN E RREZIKUT TË MONEDHËS NË BANKA

Banka e Shqipërisë ka ndërmarrë një sërë masash për menaxhimin e rrezikut të monedhës. Rregullorja “Për administrimin e rrezikut të kredisë” përkufizon ekspozimin ndaj rrezikut të monedhës, rastet e huamarrjes në monedhë të huaj në kushtet kur të ardhurat janë në monedhë të ndryshme nga monedha e përfitimit të huas. Rregullorja “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit” përcakton kërkesë të shtuar për kapital me 50% për hua të tilla. Kështu, koeficienti i rrezikut të një huaje për shtëpi rritet nga 35% në 85%, në kushtet ku huamarrësi është i ekspozuar ndaj rrezikut të monedhës. Si rrjedhim, madhësia e kapitalit në “dispozicion” të kësaj huaje, për shkak të rrezikut të monedhës, është më e lartë. Përtej kërkesave rregullative, bankat kanë marrë masa të brendshme për menaxhimin efektiv të këtij rreziku; ato kanë vendosur limite për strukturën e portofolit sipas monedhave, duke synuar gradualisht rritjen e peshës së portofolit në lek. Gjithashtu edhe kriteret e huadhënies ndryshojnë. Përgjithësisht, bankat caktojnë nivel më të shtrenguar për raportin e të ardhurave ndaj borxhit, apo raport më të lartë të mbulimit me kolateral për kredimarrësit e ekspozuar ndaj rrezikut të monedhës.



nga Prof. Asoc. Dr. Ermira QOSJA

Lektore

UNIVERSITETI EUROPIAN I TIRANËS
(UET)

Bankingu është një industri shërbimi dhe si e tillë e ka shumë të rëndësishme menaxhimin e burimeve njerëzore. Menaxhimi i rrezikut dhe i njerëzve janë dy sfidat kryesore me të cilat bankat përballen dhe mbi këtë bazë, suksesin e tyre në treg e përcakton pikërisht mënyra se si ato i menaxhojnë njerëzit dhe rrezikun. Menaxhimi efikas i rrezikut nuk mund të jetë i mundur pa njerëz të aftë dhe efikasë. Bankingu ka qenë dhe do të jetë një "people business", përtej gjithë zhvillimeve të teknologjisë që sigurisht kanë ndikuar operacionet e tij, ndërkohë që njerëzit zgjedhin apo vazhdojnë të punojnë në një bankë për arsye të cilat shkojnë përtej shpërblimit. Në kapacitetin e tyre si punëdhënës, bankat duhet të përpiqen të diferencojnë veten, duke krijuar imazhin e tyre, veçanërisht në situata të një konkurrence të lartë në tregun ku operojnë.

Në kohën e sotme, mbijetesat e bankave do të varet nga kënaqësia e konsumatorit, ku mosplotësimi i pritshmërive të tij do ta vështirësojë mbijetesën e tyre. Bankat, në

BANKINGU ose "People business"

Bankat gjithnjë e më shumë duhet të planifikojnë saktë personelin që u duhet, nga pikëpamja e aftësive, shprehive dhe roleve të përcaktuara shumë qartë prej saj. Planifikimi i burimeve njerëzore duhet të ndjekë një qasje të ciklit të jetës, që nis me rekrutimin dhe përfundon me daljen në pension të punonjësit.


menaxhimin e marrëdhënieve me publikun, artikulojnë dhe theksojnë vazhdimisht vlerat themelore të tyre, për të mbajtur dhe për të tërhequr segmente të caktuara të klientëve. Vlera të tilla si: "e besueshme", "inovative", "ndërkombëtare", "përgjegjësi sociale", "shqiptare", etj, duhet të theksohen përmes veprimeve konkrete në "terren" dhe këtë gjë e realizojnë çdo ditë punonjësit e bankës. Drejtuesit ekzekutivë të bankave i konsiderojnë burimet njerëzore si ofertë afatshkurtër, për më tepër sipas tyre, cilësia bëhet gjithnjë e më e diskutueshme. Gjithsesi, është krejt e qartë që, si çdo burim me ofertë afatshkurtër, ajo duhet menaxhuar me kujdes për të mirën e shoqërisë e për këtë arsye i duhet kushtuar vëmendje nga të gjithë. Nëse bankave u duhet të mbijetojnë, duhet vlerësuar me kujdes i gjithë spektri i praktikës së burimeve njerëzore dhe mbi këtë logjikë, menaxhimi i njerëzve do vazhdojë të mbetet sfida për ta.

Sfidat kryesore me të cilat përballen menaxhimi i burimeve njerëzore kanë të bëjë me planifikimin, gjetjen e njerëzve të duhur, mbajtjen dhe zhvillimin e tyre dhe menaxhimin e ndarjes, apo të largimit të tyre nga bankat. Natyrisht, bankat sot përballen me një ofertë në tregun e punës e cila kulturalisht ndryshon nga ajo e 10 viteve më parë. Bankat gjithnjë e më shumë duhet të planifikojnë saktë personelin që u duhet, nga pikëpamja e aftësive, shprehive dhe roleve të përcaktuara shumë qartë prej saj. Planifikimi

i burimeve njerëzore duhet të ndjekë një qasje të ciklit të jetës, që nis me rekrutimin dhe përfundon me daljen në pension të punonjësit. Më tej, kjo duhet të jetë e integruar me planin e biznesit dhe strategjinë e bankës.

Planifikimi i njerëzve është një kërkesë shumë e rëndësishme që bankat të zhvillojnë vet "markën" e tyre si punëdhënës; rrjedhimisht, kjo sjell tërheqjen, angazhimin dhe

Për epokën që jetojmë duket që sfida të forta e presin frontin e menaxhimit të talenteve dhe të "punëtorëve të dijes", ku bankat dhe universitetet kanë shumë për të reflektuar e për të bërë. Në këtë kuadër, gjithnjë e më shumë po përforcohet idea, se universitetet nuk janë vetëm "fabrikat" e dijes, por janë edhe "fabrikat" e aftësive dhe të fuqisë punëtore të arsimuar dhe gjithnjë e më shumë po flitet për universitetet sipërmarrëse dhe edukimin e orientuar nga kërkesat e tregut.



Me shërbimin MPAY

ju mund të kryeni nga celulari juaj:

- Pagesën e faturave si energji elektrike, telefoni celulare
- Rimbushjen e kartave me parapagesë “Top up”
- Pagesë e kartave të Digitalb
- Kontrollin e balancës së llogarisë bankare

Pas regjistrimit në degën e bankës me shërbimin MPAY, duke telefonuar #777# ju mund të vazhdoni më tej me kryerjen e pagesave.

QENDRA E SHËRBIMIT TË CILËSISË

0800 48 48 (pa pagesë)

+355 (0)68 40 12121; +355 (0)69 40 12121;

E Hënë - E Shtunë 09:00 - 19:00

SE BASHKU FORCOJME SHPIRTIN E SKUADRES



SOCIETE GENERALE
ALBANIA

mbajtjen e talenteve në organizatë. Bankat do të duhet të planifikojnë një program të qëndrueshëm të rekrutimit, të përshtatjes së aftësive me ndryshimet e shpejta teknologjike dhe të menaxhimit të ndryshimit, për shkak të punës së brezave, të cilët kulturalisht ndryshojnë nga njëri-tjetri, por që u duhet të punojnë në grup.

Por çfarë lloj talenti kërkojnë bankat? A kanë ato nevojë për njerëz të kualifikuar apo për njerëz që përshtaten shpejt? Shpesh dëgjon nga drejtuesit e burimeve njerëzore të bankave që kanë vështirësi për të gjetur njerëzit e duhur në zonat interurbane apo në qytetet e vogla. Ndoshta ka ardhur koha që bankat të mendojnë se duhen forma të tjera për të rekrutuar njerëzit dhe këtu universitetet mund sjellin një kontribut të qenësishëm, si shpesh dhe e bëjnë.

Natyrshëm lind pyetja: Si do të gjenden talentet, kur dihet që numri i tyre është i kufizuar dhe ata janë në objektivat e bankave, institucioneve financiare, shoqërive të sigurimit, të telefonisë dhe industrive të tjera, që janë në rrugën e shpejtë të rritjes e që kanë nevojë për punonjës të talentuar? Ndërkohë që burimet njerëzore kërkojnë aplikime online për punësim, zhvillojnë teste e intervistojnë njerëz, pyetja që shrohet shpesh është: A po gjejnë njerëzit e duhur? Jo rrallë ndodh që, për shkak të mungesës së testeve psikologjike, njerëzit që zgjidhen kanë mendje të ndritur, por jo të përshtatshme për të kryer punët që u jepen.

Të gjejsh njerëzit e duhur është vetëm një aspekt, por sfida është t'i mbash t'i zhvillosh ata më tej. Kjo çështje ngërthen disa dimensionet, që nga trajnimi e zhvillimi i punonjësve, matja e ecurisë, politikat e promovimit, politikat e transferimit, menaxhimi i talentit, komunikimi, etj. Natyra e biznesit bankar kërkon trajnime/zhvillime masive të punonjësve ekzistues dhe aftësi që duhen përmirësuar vazhdimisht. Shumica e trajnimeve sot në banka bëhen "in house", natyrisht kjo vlen për trajnimet që kanë të bëjnë me programet/platformat teknike dhe të IT-së. Ndërkohë, trajnimet/zhvillimet e tjera duhet dhe mund të bazohen nga njëra anë në kërkesat e çdo punonjësi dhe nga ana tjetër në nevojat e institucionit, por jo të shihen si e njëjta masë shpërblymje për të gjithë dhe për më tepër mund të jenë pjesë e bashkëpunimit me operatorë të tjerë në treg, përfshi këtu dhe universitetet.

Për epokën që jetojmë duket që sfida të forta e presin frontin e menaxhimit të talenteve dhe të "punëtorëve të dijes", ku bankat dhe universitetet kanë shumë për të reflektuar e për të bërë. Gjithnjë e më shumë po përforcohet idea, se universitetet nuk janë vetëm "fabrikat" e dijes, por janë edhe



Roli i bankave është shumë i rëndësishëm në drejtim të praktikave profesionale, internship-eve, ku studentët mësojnë si funksionojnë ato dhe që i krijojnë mundësinë të venë në jetësojnë dijet e tyre teorike, pa harruar në asnjë moment që për një student të sapodiplomuar fitimi i një vendi pune sot është padyshim një nga objektivat më të mëdha të tij. Idetë novatore dhe projektet e kërkimit shpesh gjenerohen nga kërkimi në universitete dhe ky është një tjetër aks i bashkëveprimit banka - universitet.



"fabrikat" e aftësive dhe të fuqisë punëtorë të arsimuar dhe gjithnjë e më shumë po flitet për universitetet sipërmarrëse dhe edukimin e orientuar nga kërkesat e tregut. Universitetet janë prodhuesit kryesorë të të diplomuarve në tregun e punës; prej tyre kërkohet vazhdimisht të ngushtojnë hendekun ndërmjet aftësive të të diplomuarve dhe aftësive të kërkuara nga tregu i punës. Në këtë këndvështrim, ridizenjimi i programeve është kthyer në një objektivat të ri për universitetet, duke bërë të mundur që të diplomuarit të jenë të gatshëm të hyjnë në tregun e punës. Zhvillimi dhe përmirësimi i programeve të universiteteve duhet të ndikohet nga kërkesa e organizatave në treg, të

cilat diferencohen nga madhësia dhe lloji i veprimtarisë. Mbi këtë bazë diferencohen tre lloje organizatash: (1) organizatat e matura, të cilat ofrojnë punë të strukturuar për të diplomuarit dhe kanë fuqinë të llobojnë me universitetet, për të përmirësuar kurrikulat bazuar në nevojat e tyre (ku bëjnë pjesë dhe bankat); (2) shoqëritë tregtare në zhvillim, të cilat mund të konsiderohen si të papërvojta dhe që nuk e kanë fuqinë për të ndryshuar kurrikulat e universiteteve dhe (3) ndërmarjet e vogla, që nuk kanë aftësinë për të trajnuar të diplomuarit, por që i kërkojnë ata shumë të aftë dhe të gatshëm për të punuar.

Më tej, roli i bankave është shumë i rëndësishëm në drejtim të praktikave profesionale, internship-eve, ku studentët mësojnë si funksionojnë ato dhe që i krijojnë mundësinë të venë në jetësojnë dijet e tyre teorike, pa harruar në asnjë moment që për një student të sapodiplomuar fitimi i një vendi pune sot është padyshim një nga objektivat më të mëdha të tij. Idetë novatore dhe projektet e kërkimit shpesh gjenerohen nga kërkimi në universitete dhe ky është një tjetër aks i bashkëveprimit banka - universitet.

Zhvillimi ekonomik e social i vendit natyrshëm ndikohet nga bashkëpunimi banka dhe universitete, e për këtë arsye, ato duhet dhe mund të synojnë më shumë ndërveprim e komunikim mes tyre, porë si "people business", aktorë të tregut të punës dhe si përgjegjësi sociale. Kjo ka qenë dhe filozofia e Universitetit Europian të Tiranës, teksa formalizoi së fundi bashkëpunimin me Shoqatën Shqiptare të Bankave. Kjo e fundit dhe më specifiku Komiteti i Burimeve Njerëzore të saj, kanë marrë përsipër një proces bashkëpunimi e komunikimi me universitetet, që mesa duket rezultoi të jetë në rrugën e mbarë për të gjithë aktorët pjesëmarrës në këtë proces ndërveprues.



nga Zj. Iva NATHANAILI

Këshilltare Juridike
PRICEWATERHOUSE COOPERS
ALBANIA

Në vitin 2013, me nismën e Bankës së Shqipërisë, u miratuan për herë të parë dispozita ligjore mbi marrëveshjet e kolateralit financiar, si pjesë e ligjit nr.133/2013: “Për sistemin e pagesave”, të njehsuara plotësisht me Direktivën 2002/47/KE të Parlamentit Europian dhe Këshillit të Bashkimit Europian. Marrëveshjet e kolateralit financiar janë disajnuar për të krijuar një garanci mbi cash-in në llogaritë bankare dhe instrumentet financiare, të tilla si: aksionet, obligacionet, apo tituj të tjerë të ngjashëm, të negociueshëm për një transaksion financiar ndërmjet pjesëmarrësve profesionalë në tregun financiar dhe një personi juridik. Pavarësisht përparësive që paraqet kolaterali financiar, në krahasim me format e tjera të garancisë sot, pas më pak se dy viteve nga miratimi i tij, zbatohet minimalisht në praktikë.

PËRPARËSITË E PËRDORIMIT TË KOLATERALIT FINANCIAR (SIPAS PERSPEKTIVËS SË NJË TRANSAKSIONI HUAJE)

Përparësitë e theksuara nga tregu financiar

Përse jemi konservatorë për kolateralin financiar?

◀◀ Akomodimi i kolateralit financiar në Shqipëri ende nuk është kryer mbi bazën e një reforme të gjithanshme në legjislacion. Në ndryshim nga shtetet e BE-së, të cilët ndryshuan njëherësh ligjet e brendshme, duke i përshtatur me Direktivën e kolateralit financiar, në Shqipëri ky proces është kryer vetëm pjesërisht.

europian e skemës së kolateralit financiar janë lehtësimi i formaliteteve në krijimin dhe ekzekutimin e kolateralit, minimizimi i rrezikut të kredisë dhe standardizimi i trajtimit të kolateralit financiar në shtete të ndryshme, në rastin e transaksioneve ndërkombëtare.

Së pari, çdo formalitet për krijimin dhe ekzekutimin e kolateralit financiar minimizohet. Për efekt vlefshmërie, ekzekutueshmërie dhe publiciteti mjafton vetëm forma shkresore e kontratës dhe është e panevojshme ndërhyrja e një noteri, përmbaruesi privat, gjykatë, regjistri, ose çdo autoriteti tjetër publik. Si rrjedhim, kolateral-marrësi, p.sh. banka, në një rast mos-përmbushje të detyrimit, menjëherë përvetëson kolateralin në cash, ose përvetëson apo shet instrumentin financiar. Lidhur me hipotekën dhe barrët siguroese, këto garanci rëndohen nga formaliteti i lidhjes së kontratës së hipotekës te noteri, përfshirë edhe në rastin e barrëve siguroese, për të cilat është e mjaftueshme forma shkresore. Gjithashtu, kosto e regjistrimit të detyrueshëm të kontratës së hipotekës në Regjistrin e Pasurive të Paluajtshme është tepër e lartë, sidomos në rastin e huave me vlerë mbi 10.000.000 lekë, pasi tarifa e regjistrimit do të vendoset për çdo pronë të hipotekuar. Operimi i një sistemi të tillë pengon elasticitetin e tregut financiar dhe rrjedhshmërinë e zhvillimit të transaksioneve në këtë treg.

Së dyti, kolaterali financiar minimizon

rrezikun e kredisë (mospagimit) së kundërpalës. Banka ka të drejtë të jetë kreditor i radhës së parë për të përfutur nga ky kolateral, edhe nëse kredimarrësi, p.sh. biznesi, i është nënshtruar ndërkohë një procesi falimentimi. Në një proces falimentimi do të njihet edhe marrëveshja e kompensimit kontraktual të detyrimeve të ndërsjellta të palëve. Kjo prodhon një detyrim të vetëm të pagueshëm të njëjës palë ndaj kundërpalës, çka zvogëlon dukshëm vlerën e kolateralit të nevojshëm për të mbuluar transaksionin dhe rrjedhimisht, masën e ekspozimit.

Së treti, duke qenë se ligji shqiptar është harmonizuar me ligjet e shteteve të BE-së, një investues i huaj i një biznesi shqiptar do të mund të ekzekutoonte kolateralin financiar në Shqipëri njësoj si çdo të bënte në çdo shtet tjetër të BE-së. Kjo përkthehet në stabilitet ligjor, si shumë i kërkuar në transaksionet ndërkombëtare.

ARSYET E MOSFUNKSIONIMIT NUK JUSTIFIKOJNË MOSZBATIMIN E SISTEMIT TË KOLATERALIT FINANCIAR

Pavarësisht përparësive të dukshme të kolateralit financiar në mbulimin e rrezikut të mbartur nga transaksionet financiare, debate kontradiktore shoqëruan menjëherë periudhën e pas-miratimit të kolateralit financiar, nga akademikë dhe profesionistë të fushës bankare dhe ligjore. Argumenti kryesor i ngritur ishte se tregu ynë financiar është

ende i brishtë dhe i vogël për të akomoduar këtë sistem të hartuar, më së shumti, për t'iu përgjigjur nevojave të një tregu aktiv transaksionesh ndërkombëtare. Në rrethanat ku Banka e Shqipërisë raporton tkurrje të huadhënies bankare për bizneset, kërkesa e bankave për kolateral është mbajtur e lartë. Deri në gjysmën e parë të vitit 2014, 80% e huave bankare me probleme janë të garantuara me hipotekë. Megjithatë, vihet re një diversifikim i kolateralit nga bankat, që justifikohet me vështirësitë e viteve të fundit të hasura për administrimin e kolateralit në formë të pasurisë së paluajtshme, administrim i cili shkon përtej ekspertizës së një banke tregtare. Kështu, në janar 2015, bankat raportojnë një mbulim të madh të ekspozimeve të tyre me cash kolateral, në krahasim me format e tjera të garancive. Gjithsesi, diversifikimi (i kolateralit) i orientuar drejt cash kolateralit nuk ushtrohet drejt në praktikë. Regjistri i Barrëve Siguruese në Tiranë dhe praktika ligjore konfirmojnë se bankat vijojnë të zbatojnë sistemin e vendosjes së barrëve siguruese mbi cash kolateralin apo mbi aksionet, edhe pse sipas ligjit duhet të përdorin sistemin e kolateralit financiar. Në një rast ekzekutimi të detyrueshëm, kjo praktikë mund të shndërrohet në faktor rreziku operacional (rrezik ligjor) për ekspozimet bankare, sepse marrëveshjet e barrave siguruese, të krijuara pas datës së hyrjes në fuqi të sistemit të kolateralit financiar, rrezikojnë të mos njihen nga gjykata dhe përmbaruesi gjyqësor, për sa kohë kanë objekt cash-in dhe instrumente financiare.

Megjithatë akomodimi i kolateralit financiar në Shqipëri ende nuk është kryer mbi bazën e një reforme të gjithanshme në legjislacion. Kjo mendohet të ketë sjellë një pasiguri tjetër në zbatimin e tij. Në ndryshim nga shtetet e BE-së, të cilët ndryshuan njëherësh ligjet e brendshme, duke i përshtatur me Direktivën e kolateralit financiar, në Shqipëri ky proces është kryer vetëm pjesërisht. Ligji shqiptar nuk përputhet plotësisht me frymën e sistemit të kolateralit financiar, sipas të cilit duhet të eliminohet çdo formalitet publiciteti dhe regjistrimi pranë një organi apo regjistri publik. Shoqëritë aksionare detyrohen të regjistrojnë ende në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit garancitë mbi aksionet, përfshirë kështu edhe kolateralin financiar.

Edhe ligji kuadër për falimentimin duhet të ndryshohet për të akomoduar përparësitë e ekzekutimit të kolateralit financiar në disa aspekte. Së pari, aktualisht hapësira interpretimi mund të ekzistojnë në ligjin për falimentimin, për t'i trajtuar kolateral-mbajtësit financiar në dy mënyra: si kreditorë të siguruar, ose kreditorë me të drejtë veçimi.

Megjithatë, ligji për falimentimin duhet të njohë shprehimisht trajtimin preferencial të kolateral-mbajtësit financiar ndaj çdo kreditori tjetër me pretendime konkurrencte, me synim shmangien e interpretimeve dhe praktikave të kundërta nga administratori i falimentimit. Së dyti, nga përplasja e ligjit mbi kolateralin financiar dhe ligjit për falimentimin krijohet një konflikt kompetencash nga njëra anë, mes administratorit të falimentimit, që mbledh pretendimet e kreditorëve dhe shpërndan dhe/ose veçon pasuri nga



Diversifikimi (i kolateralit) i orientuar drejt cash kolateralit nuk ushtrohet drejt në praktikë. Regjistri i Barrëve Siguruese në Tiranë dhe praktika ligjore konfirmojnë se bankat vijojnë të zbatojnë rëndom sistemin e vendosjes së barrëve siguruese mbi cash kolateralin apo mbi aksionet, edhe pse sipas ligjit duhet të përdorin sistemin e kolateralit financiar.



masa e falimentimit për ta, e nga ana tjetër, kolateral-marrësit financiar, që përvetëson/shet vet kolateralin pa ndërhyrjen e asnjë autoritetit, përfshirë një administratori falimentimi. Në këtë rast, ligji për falimentimin duhet të njohë të drejtën e kolateral-mbajtësit

financiar për të ekzekutuar kolateralin e tij lirisht, sikurse do të vepronte nëse nuk do të ekzistonte procedura e falimentimit. Së treti, ligji për falimentimin duhet të qartësojë se e drejta e kompensimit kontraktual në një transaksion mbuluar me kolateral financiar është e pakundërshtueshme dhe nuk i nënshtrohet rasteve përjashtuese në ligjin për falimentimin të cilat sfidojnë çdo të drejtë kompensimi.

Nga ana tjetër, viti 2015 shënon për sistemin bankar shqiptar një sistem të ri rivlerësimi të rrezikut të kredisë dhe mospagësës nga pala tjetër, nëpërmjet Rregullores së Bankës së Shqipërisë: "Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit për bankat", në fuqi nga data 1 janar 2015. Kjo Rregullore, e hartuar sipas standardeve për mjaftueshmërinë e kapitalit Bazel II, prezanton kolateralin financiar dhe marrëveshjet e kompensimit (përfshirë dhe netimi në bilanc) jo vetëm si teknika zbutje për rrezikun e kredisë, por kërkon nga bankat të plotësojnë kërkesat kontraktuale e ligjore, për të siguruar zbatueshmërinë e marrëveshjeve të kolateralit sipas ligjit në fuqi. Mbetet për t'u parë deri në fund të këtij viti se si kjo Rregullore do të ndikojë në kanalizimin e praktikës bankare në rrugën e drejtë ligjore të përdorimit të kolateralit financiar.

Si përfundim, sistemi i ligjeve në Shqipëri duhet ende të harmonizohet me kolateralin financiar, për t'i dhënë siguri palëve në transaksion në zbatimin e marrëveshjeve të kolateralit financiar dhe për të përfutuar maksimalisht nga përparësitë e tij. Në veçanti, ligji për falimentimin duhet të përshtatet me trajtimin e favorizuar të kolateralit financiar në mënyrë që ai të realizojë qëllimin e tij si teknikë zbutje e rrezikut të kredisë për bankat/institucionet kredidhënëse. Megjithatë, është fakt që ligji mbi kolateralin financiar sot është në fuqi dhe si çdo ligj tjetër duhet të zbatohet.





nga **Z. Andi PACANI**

Senior Associate
BOGA & ASSOCIATES

Nga data 1 janar 2015 hyri në fuqi ligji i ri për TVSH-në (ligji nr. 92/2014), i cili është përafuar pjesërisht me Direktivën e Parlamentit Europian dhe Këshillit 2006/112/KE, datë 28 nëntor 2006: “Mbi Sistemin e Përbashkët të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar”. Ligji i mëparshëm për TVSH-në parashikonte si furnizime të përjashtuara nga TVSH-ja, furnizimet në vijim: “transaksionet në lidhje me kreditë, huat, garantim kredish dhe çdo sigurim për paratë, duke përfshirë edhe administrimin e huave, kredive a garantim kredish prej dhënësit, llogaritë bankare, pagesat, transferimet, borxhet, çeqet dhe instrumentet e negociueshme, përveç mbledhjes së borxhit, transaksionet lidhur me monedhën, bankënotën dhe paranë, që janë mjete të ligjshme pagese, përveç artikujve të përdorur vetëm për koleksione, etj.”

Në mënyrë të ngjashme, ligji i ri, në nenin 53 (ç) dhe (d) përcakton si të përjashtuara nga TVSH si vijon: transaksionet, përfshirë negociimin, lidhur me veprimet e këmbimit,

TVSH-ja mbi veprimtarinë financiare

Një rast për t'u rikonsideruar



Në ndryshim nga ligji për TVSH-në, udhëzimi përkatës duket sikur kufizon zbatimin e përjashtimit nga TVSH-ja, mbi bazën e statusit të personit që ofron furnizimin. Ky kufizim duket se tejkalon rregullimet e vendosura nga ligji, i cili i referohet ofruesit të furnizimit si huadhënës dhe nuk i referohet si institucion financiar dhe aq me pak i licencuar në Shqipëri.



llogaritë e depozitave, llogaritë rrjedhëse, furnizimin e likuiditeteve nëpërmjet pagesave, transfertave, marrje-dhëniet e borxhit, çeqet dhe instrumentet e tjera të negociueshme, përveç shërbimit të mbledhjes së borxhit; dhe transaksionet, përfshirë negociimin lidhur me valutën, kartëmonedhat apo monedhat e përdorura si mjete ligjore pagese, me përjashtim të monedhave dhe të kartëmonedhave për koleksion, që do të thotë monedha ari, argjendi apo monedha të tjera metali ose kartëmonedha që nuk përdoren. Nga natyra e shërbimeve të listuara në ligjin e ri shihet se është zgjeruar gama e transaksioneve të përjashtuara, rrjedhojë kjo e zhvillimeve në tregun financiar; megjithatë, në thelb rregullimi ligjor mbetet i njëjtë. Pra, përgjithësisht shërbimet e ofruara nga bankat dhe institucionet financiare mbeten të përjashtuara nga TVSH-ja.

Udhëzimi i Ministrisë së Financave (Udhëzim nr. 6, datë 30.01.2015 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”), i nxjerrë për zbatimin e ligjit për TVSH-në, ka sqaruar rastet kur shërbimet financiare janë të përjashtuara. Po ashtu, ky udhëzim sqaron cilat shërbime, edhe pse të ofruara nga bankat, apo institucionet financiare, janë të tatuueshme. Vlen të theksohet se, në ndryshim nga ligji për TVSH-në, udhëzimi duket sikur kufizon zbatimin e përjashtimit nga TVSH-ja mbi bazën e statusit të personit që ofron furnizimin. Konkretisht, në nenin 41 të udhëzimit, paragrafi

i parë, përcaktohet se: kërkohet që dhënësi i shërbimit të jetë një institucion financiar, i cili është krijuar dhe licencuar nga autoriteti kompetent në Republikën e Shqipërisë dhe me ligj lejohet të kryejë këto transaksione.



Ndonëse përjashtimi i shërbimeve financiare historikisht është parë si një rast i përjashtimit teknik, në kushtet aktuale, përjashtimi i shërbimeve financiare duhet parë edhe si interes publik dhe për qëllime sociale.



Ky kufizim duket se tejkalon rregullimet e vendosura nga ligji, i cili i referohet ofruesit të furnizimit si huadhënës (vetëm në pikat b dhe c) dhe nuk i referohet si institucion financiar dhe aq më pak i licencuar në Shqipëri. Ndërkohë, transaksionet financiare janë shumë më të gjera sesa ato që ndodhin nëpërmjet institucioneve financiare të licencuara, apo që furnizohen prej tyre. Leximi literal i këtij neni të udhëzimit krijon përshtypjen se huat, apo borxhet e dhëna midis shoqërive tregtare apo individëve,



përbëjnë një transaksion të tatueshëm me TVSH, ose që një hua e marrë nga një shoqëri, qoftë kjo institucion financiar, por jo i licencuar në Shqipëri, është transaksion i tatueshëm.

Duke iu referuar paragrafit të katërt, të nenit 41 të udhëzimit dhe shembullit pasues, rezulton se referimi ndaj institucionit financiar ka për qëllim të sqarojë në të vërtetë tatueshmërinë e ndërmjetësuesit, në rastet e dhënies së huave. Për sa më sipër, del e nevojshme që udhëzimi të ndryshohet, duke pasur parasysh së pari, sqarimin e rasteve më specifike të veprimtarive financiare, të cilat hasen më shpesh në Shqipëri dhe së dyti, korrigjimin e referencës të institucionit financiar të licencuara në Shqipëri (duke përdorur termin “kredidhënës”, siç parashikohet në ligj).

Deri më tani, lista e shërbimeve financiare përcaktohej me një shkresë të Ministrisë të Financave të vitit 2009, sipas së cilës shërbimet e marra nga operatorë të veçantë (SWIFT, Reuters, Mastercard, Visa, etj) dhe të lidhur ngushtësisht me furnizimet e kryera nga bankat dhe institucionet financiare përfshiheshin në kategorinë e shërbimeve financiare, pra ishin jo të tatueshme, duke ulur kështu koston e TVSH-së për përfituesit e tyre. Në fakt, ky klasifikim kishte të bënte me një sërë shërbimesh të lidhura pazgjydhshëmrisht me furnizime që iu ofrohen klientëve të bankave. Këto shërbime nuk kufizohen vetëm në anën teknike të transaksionit, por avancojnë në një marrëdhënie më të gjerë nga pikëpamja financiare. Ato bëhen pjesë e transaksionit financiar, duke marrë përsipër një përgjegjësi të madhe financiare, lidhur me sigurinë, vërtetësinë dhe saktësinë e transmetimit të informacionit financiar. Gjithashtu, ato marrin përsipër dhe

garantojnë transfertat financiare, e si të tilla, nuk mund të konsiderohen si shërbime të thjeshta teknike.



Shqipëria gjendet në një situatë jo të pëlqyeshme, përse i përket përdorimit të institucioneve bankare, në drejtim të transfertave brenda dhe jashtë vendit, përdorimit të kartave të kreditit apo debitit, shërbimeve të pagesave online apo mobile; si dhe lidhur me qarkullimin e mjeteve monetare jashtë këtij sistemi. Sigurisht që janë të qarta përfitimet që do të kishte shoqëria nga zgjerimi i bazës së përdoruesve të këtyre shërbimeve, por po aq e qartë është që kjo nuk mund të arrihet vetëm me përpjekjen e sistemit bankar.



Nga ana tjetër, vlen të shqyrtohen efektet që mund të ketë tatueshmëria potenciale e këtyre shërbimeve në sistemin bankar në Shqipëri. Pavarësisht emërimit, tatimi mbi vlerën e shtuar në thelb është një tatim mbi konsumin përfundimtar të mallrave dhe shërbimeve, e si i tillë, biznesi nuk duhet të përballojë apo të ketë kosto të shtuara

nga ky tatim. Si rrjedhojë, personat/bizneset, furnizimet e të cilëve janë të përjashtuar nga TVSH-ja, në të vërtetë paguajnë TVSH (njëlloj si konsumatorët finalë) dhe ata të cilët janë persona të tatueshëm dhe aplikojnë TVSH-në në shërbimet e kryera, nuk kanë kosto nga ky tatim. Bankat janë një shembull tipik i personave që paguajnë TVSH njëlloj si konsumatorët finalë, pasi nuk kanë të drejtë të zbrisin TVSH-në e paguar në blerje.

PËRJASHTIMET NGA TVSH-JA, NJË PJESE E RËNDËSISHME E SKEMËS SË TVSH-SË

Parimisht, përjashtimet nga TVSH-ja kategorizohen në dy grupe: (i) përjashtimet avantazhuese, p.sh.: dhurimet, sponsorizimet, furnizimet shëndetësore, shërbimet arsimore, veprimtaritë kulturore etj; dhe (ii) përjashtimet teknike, ku përfshihen furnizimet e pasurive të paluajtshme, shërbimet financiare dhe të sigurimit. Në grupin e parë përfshihen veprimtari të interesit publik, me qëllimin që këto përjashtime të arrijnë objektiva sociale dhe të shpërndarjes së pasurisë, d.m.th të ndikojnë për të zvogëluar efektet e natyrës regresive të TVSH-së në çmimin e furnizimeve dhe në të njëjtën kohë, të rrisin konsumin e këtyre produkteve e shërbimeve (p.sh.: veprimtaritë kulturore apo arsimore). Ndërsa në grupin e dytë përfshihen ato veprimtari të cilat, për vetë natyrën e tyre, janë të vështira për t'u përfshirë në sistemin e TVSH-së. Në këtë kontekst, pavarësisht se shërbimet financiare përfshihen në grupin e dytë, duhet t'i kushtohet një vëmendje e veçantë kushteve aktuale në të cilat ofrohen këto shërbime në Shqipëri.

Shqipëria gjendet në një situatë jo të pëlqyeshme, përse i përket përdorimit të institucioneve bankare, në drejtim të transfertave brenda dhe jashtë vendit, përdorimit të kartave të kreditit apo debitit, shërbimeve të pagesave online apo mobile; si dhe lidhur me qarkullimin e mjeteve monetare jashtë këtij sistemi. Sigurisht që janë të qarta përfitimet që do të kishte shoqëria nga zgjerimi i bazës së përdoruesve të këtyre shërbimeve, por po aq e qartë është që kjo nuk mund të arrihet vetëm me përpjekjen e sistemit bankar.

Pra, ndonëse përjashtimi i shërbimeve financiare historikisht është parë si një rast i përjashtimit teknik, në kushtet aktuale, përjashtimi i shërbimeve financiare duhet parë edhe si interes publik dhe për qëllime sociale. Ulja e barrës tatimore për shërbimet e reja dhe inovative dhe xitja e tyre me çdo mënyrë duhet të jetë patjetër të jetë pjesë e paketës fiskale.

Jemi rritur së bashku!

www.tiranabank.al

PIRAEUS BANK GROUP



**TIRANA
BANK**

tani mundesh



nga Z. Adriatik BALLHYSA

Zv. Drejtor i Departamentit të IT
& Përgjegjës i Sektorit të Sigurisë së
Informacionit
SOCIÉTÉ GÉNÉRALE ALBANIA

Çdo ditë e më shumë po ndeshemi me fjalë dhe terma të rinj, si: siguria kibernetike, mashtrime në internet, kopjim i kartave, përvetësim i llogarisë, thyerje e fjalëkalimit, kërcënime ngulmuese të avancuara, sulme për qëllime specifike, etj. Nëse deri dje këto terma dhe metoda mashtimi dukeshin të largëta për individët, bizneset dhe institucionet financiare shqiptare, aktualisht po bëhen të prekshme dhe për ne. Tashmë vihet re një prirje dhe zhvendosje e kërcënimeve, nga ato me qëllime minimaliste (vjedhja e një llogarie e-mail-i, apo rrjetesh sociale), tek ato me përfitime monetare. Nuk do të jetë e largët koha që edhe në Shqipëri të dëgjojmë publikisht për kërcënime, apo dhe sulme të suksesshme. Përdorimi më i madh i kanaleve elektronike të komunikimit në Shqipëri, ka bërë të mundur që bankat të rrisin ofertën për banking-un në internet, e si rrjedhojë të rritet vëmendja e keqbërësve, të cilët përdorin këto kanale për qëllimet

Siguria e informacionit e orientuar nga biznesi



Përforcimi i masave të sigurisë për produktet dhe shërbimet e ofruara përmes internetit përbën një avantazh konkurrues në treg, që bankat mund ta reklamojnë pozitivisht, me qëllim tërheqjen e klientëve skeptikë ndaj këtyre lloj produktesh e shërbimesh.



e tyre. Përgatitja e biznesit shqiptar dhe e bankave për këto lloj sulmesh duhet të bëhet paralelisht me rritjen e kërkesës dhe ofertës për këto shërbime.

Sipas një sondazhi të kryer në vitin 2014 nga Kaspersky Lab për Rreziqet e Sigurisë për Konsumatorin, ka një rënie në besimin e konsumatorëve mbi sigurinë në lidhje me transaksionet financiare online. Rezultatet e sondazhit treguan se 49% e të anketuarve



Banking-u në internet është një nga pikat më të dobëta të sigurisë së informacionit, por ai nuk është i vetmi shërbim që përdor internetin e që rrjedhimisht mbarat rreziqe. Përfitimet dhe lehtësitë nga interneti janë po aq të mëdha sa dhe rreziqet. Bankat, më shumë se çdo biznes tjetër, duhet t'i kushtojnë vëmendje çdo lloj informacioni në internet, si dhe çdo lidhje e komunikimi nëpërmjet tij (e-mail, kërkimi, etj).

në mbarë botën ndiheshin të pasigurt gjatë transaksioneve financiare përmes internetit dhe 42% e tyre deklaruan se do t'i përdornin me shpesh sistemet e pagesave online, nëse ndjenin se ato do të ishin më të mbrojtura nga mashtrimi kibernetik, faktor ky shumë i rëndësishëm për konsumatorët, kur ata zgjedhin dyqanet e shitjeve online, ose operatorët e shërbimeve financiare. Rreth 60% e të anketuarve deklaruan se do të preferonin shoqëritë që ofrojnë masa të shtuara sigurie për mbrojtjen e të dhënave financiare. *Për më tepër, 75% e të anketuarve shprehën pritshmërinë e tyre se, duhet të jenë bankat, sistemet e pagesave online dhe dyqanet e shitjeve online, që të mbrojnë kompjuterat dhe pajisjet e tyre celulare nga mashtrimet financiare.*

Nga sa më sipër, del një përfundim i rëndësishëm për tregun shqiptar: Përforcimi i masave të sigurisë për produktet dhe shërbimet e ofruara përmes internetit përbën një avantazh konkurrues në treg, që bankat mund ta reklamojnë pozitivisht, me qëllim tërheqjen e klientëve skeptikë ndaj këtyre lloj produktesh e shërbimesh.

Duke vlerësuar rrezikun dhe nevojën për një qasje të re përkundrejt sulmeve të avancuara në rritje, Banka Qendrore Europiane (forumi Secure Pay) publikoi në janar 2013 një listë me rekomandime për



sigurinë e transfertave në internet¹. Nisur nga fakti se Shqipëria është vend kandidat për në BE, ky legjislacion (përfshirë kuadrin rregullator bankar), në një të ardhme të afërt do të njësohet me atë evropian dhe është mirë që keto kërkesa të adresohen apriori. Disa prej rekomandimeve të këtij dokumenti, që tregojnë se si institucionet financiare mund t'i adresojnë më mirë kërcënimet që vijnë nga ofrimi i produkteve dhe shërbimeve përmes internetit, janë:

- “Autentikimi i fortë” për klientët, për të gjitha pagesat në internet;
- Mbrojtje në shumë shtresa për internetin dhe një kornizë e dokumentuar dhe e dedikuar për sigurinë e këtyre shërbimeve;
- Mjetet e përshtatshme të sigurisë, që bëjnë të mundur monitorimin, zbulimin dhe mundësinë e bllokimit të transfertave në internet, sa më në kohë reale;
- Procedura efektive identifikimi, verifikimi dhe kontrolli për klientët, përpara hapjes së llogarive;
- Kushte të qarta në kontratat e bashkëpunimit midis ofruesve të shërbimeve të pagesave dhe tregtarëve elektronikë, si dhe ofruesve të nënkontraktuar të shërbimeve, lidhur me standardet e sigurisë.

SI MUND TË ARRIHET NJË NIVEL I PRANUESHËM I SIGURISË SË INFORMACIONIT NË INSTITUCIONET FINANCIARE?

Në vijim paraqiten disa drejtime që mund të ndihmojnë në sigurimin e një niveli të kënaqshëm të sigurisë së informacionit në institucionet financiare.

Zbatimi i standardeve dhe analiza e rrezikut. Çdo kërkesë e imponuar nëpërmjet standardeve dhe detyrimeve rregullatore është rezultat i përfundimeve dhe mësimave të nxjerra nga studimet, kërcënimet reale dhe praktikata më të mira. Janë të shumtë standardet që duhen patur parasysh, ku disa mund të mos jenë të detyrueshëm, por janë një vlerë e shtuar në analizë (ISO 27001, PCI DSS, etj), ndërsa përsa i përket kuadrin të detyrueshëm rregullator, mund të përmendim Rregulloret e Bankës së Shqipërisë, Udhëzimet e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ato të Parandalimit të Pastrimit të Parave, etj. Çdo kërkesë e tyre duhet të pasqyrohet në

një plan veprimi dhe shpesh në investime për bankat. Me qëllim që këto të jenë efektive, të pranueshme, të zbatueshme dhe realiste, hapi i parë që duhet të ndërmerret është *krijimi i një programi të vlerësimit të rrezikut*. Rol të madh këtu mund të luajë dhe auditimi. Gjetjet dhe pikat e dobëta, të shprehura në raporte të auditit, mund të përfshihen në këtë analizë.



Bizneset harxhojnë miliona dollarë në “muret mbrojtëse”, enkriptime dhe pajisjet që sigurojnë akses së sigurtë dhe kjo është parë e harxhuar kot, pasi asnjë prej këtyre masave nuk adreson hallkën më të dobët në zinxhirin e sigurisë.



Mbështetja e Grupit Menaxhues. Pa mbështetjen e menaxhimit të lartë, asnjë plan nuk mund të realizohet. Menaxhimi i lartë i institucioneve financiare (dhe jo vetëm) duhet të ketë informacion të plotë për nivelin e rrezikut ndaj institucionit dhe të mbështesë planin e masave për adresimin e rrezikut që në një. Me mbështetje nga menaxhimi nuk kuptohet thjesht firmosja e dokumentit dhe fillimi i punës për zbatimin e planit të masave për adresimin e rrezikut. Katër janë zgjedhjet që mund të bëjë menaxhimi për të adresuar rrezikun: 1. Ta pranojë dhe të vazhdojë biznesin, 2. Ta shmangë, p.sh. të mos e hedhë në treg një produkt ose shërbim, 3. Ta transferojë, p.sh. ta sigurojë produktin apo veprimtarinë në një shoqëri sigurimesh, 4. *Ta minimizojë atë.*

Siguri e shtresëzuar, siguri e thellë. Minimizimi i rrezikut nënkupton vendosjen e kontrolleve që duhet të ekzistojnë në çdo shtresë, pasi duhet të kompensojnë njëri-tjetrin. Nuk ka kontroll të përsosur dhe shumë funksional. Teknikisht këto kontrole mund të paraqiten si: encryption, hardening, patching, network segmentation, network firewall, application firewall, proxy, reverse proxy, internet gateway, vulnerability assessment, IPS/IDS, SIEM, antivirus, backups, access control, access

rights, logs, business level conciliations, etj. Një listë shumë e vyer për kontrollet është edhe lista me 20 kontrollet kritike të sigurisë nga SANS².

Veprimet operacionale të sigurisë së informacionit. Kontrollet duhen monitoruar dhe testuar vazhdimisht. Kjo është puna e përditshme e punonjësve të sigurisë së informacionit, të cilët duhet të propozojnë kontrole në çdo shtresë dhe t'i kontrollojnë ato, të sigurohen që janë efektive dhe të mund të parandalojnë, apo pikasin në kohë sulme të mundshme. Janë ata që duhet të krijojnë dhe drejtojnë një plan veprimi dhe rikuperimi në r rast incidentesh; që bëjnë analizën e rrezikut dhe propozojnë masa për rritjen e nivelit të sigurisë dhe të integrohen që në fillim të çdo projekti, për të mundësuar integrimin e sigurisë së informacionit të projektit, pasi *kështu siguria do të kushtojë më pak*. Punonjësit e sigurisë së informacionit, gjithashtu duhet të merren me edukimin dhe imponimin e një sjelljeje të pëlqyeshme për punonjësit dhe kultivimin në organizatë të kulturës së kujdesit përkundrejt sigurisë së informacionit.

Edukimi dhe ndërgjegjësimi i përdoruesit. Në sondazhet e disa viteve më parë, pyetjes: “Cila është sfida më e madhe me të cilën përballet shoqëria tuaj?”, shumë nga profesionist të fushës së sigurisë i janë përgjigjur: “Përdoruesi/punonjësit e brendshëm”. Kjo përgjigje, në vitet e fundit, është zëvendësuar me: “kërcënimin kibernetik”, por sërish pjesa e rrezikut që vjen nga punonjësit duket se është e konsiderueshme³. Përdoruesi/punonjësi vazhdon të konsiderohet si një nga pikat më të dobëta të sigurisë së informacionit. Përdoruesit, qofshin këta teknikë apo jo, janë ata që kanë akses të drejtpërdrejtë tek të dhënat dhe që perceptojnë më pak rrezikun që i kanoset informacionit që kanë në përdorim, ose që e mirëmbajnë. Me qëllim që përdoruesit të bëhen partnerë në objektivin tonë për mbrojtjen e informacionit (dhe jo vetëm), në çdo organizatë duhet të zbatohet një program trajnimi dhe ndërgjegjësimi. Nëse trajnimi i vazhdueshëm sjell përvetësimin e aftësive të reja teknike, ndërgjegjësimi ndryshon pozitivisht perceptimin, sjelljen dhe kulturën e përdoruesve, në favor të mbrojtjes së sigurisë së informacionit.

¹ <http://www.ecb.europa.eu/pub/pdf/other/recommendationssecurityinternetpaymentsoutcomeofpcfinalversionafterpc201301en.pdf?ea09bd2b9f5008bf6308c8ebd5a74156>

² <http://www.sans.org/critical-security-controls/>

³ [http://www.ey.com/Publication/vwLUAssets/EY-global-information-security-survey-2014/\\$FILE/EY-global-information-security-survey-2014.pdf](http://www.ey.com/Publication/vwLUAssets/EY-global-information-security-survey-2014/$FILE/EY-global-information-security-survey-2014.pdf)



nga Prof. Dr. Adrian CIVICI

President

UNIVERSITETI EUROPIAN I TIRANËS,
(UET)

Kriza financiare globale dhe zhvillimet me natyrë makroekonomike që pasuan gjatë viteve 2009-2014 dëshmuar edhe për nevojën e përmirësimeve thelbësore në sferën e rregullimeve të sistemeve financiare, veçanërisht në kompletimin e tyre me masa dhe politika makroprudenciale. Për ta bërë sa më operationale dhe sa më eficiente politikën makroprudenciale, është e nevojshme të jenë sa më qarta objektivat e saj, instrumentet dhe masat që mund të zbatohen në këtë kuadër. Vitet e fundit, këto çështje kanë tërhequr shumë vëmendjen e bankave qendrore, ministrive të financave, institucioneve financiare ndërkombëtare, mjediseve akademike universitare, etj..

Megjithëse nocioni “politikë makroprudenciale” nuk po gjen ende një përkufizim unik, në mënyrë më të përgjithshme po konceptohet si një “perspektivë makroekonomike mbikëqyrjeje e sistemit financiar”, e cila gjatë këtyre viteve ishte konceptuar në nivel “mikro”. Pjesa më e madhe e ekono-

Roli i politikave makroprudenciale në stabilitetin financiar

“ Më shumë se sa menaxhimi i krizave financiare, objektivi final i politikave makroprudenciale duhet të jetë promovimi i stabilitetit financiar, ndërkohë që objekti kryesor i punës së tij është forcimi i rezistencës së sistemit financiar dhe pengimi i akumulimit të rreziqeve sistematike.

mistëve, financierëve dhe bankierëve bien dakord se: “më shumë se sa menaxhimi i krizave financiare, objektivi final i politikave makroprudenciale duhet të jetë promovimi i stabilitetit financiar, ndërkohë që objekti kryesor i punës së tij është forcimi i rezistencës së sistemit financiar dhe pengimi i akumulimit të rreziqeve sistematike”.

Gjithsesi, kriza dhe periudha pas saj

“ Studime të shumta provojnë se problemi i ndërveprimit të politikave makroprudenciale me politikat e tjera ekonomike është mjaft i rëndësishëm. Përfshirja e bankave qendrore në këtë sferë duhet të bëhet në mënyrë të tillë që, zbatimi i politikave makroprudenciale të mos interferojë me politikat monetare dhe të reduktojë në maksimum konfliktin e objektivave të tyre, për arsye se kanalet e transmetimit të këtyre politikave janë të përafërta.

dëshmoi se “stabiliteti financiar nuk varet vetëm nga stabiliteti i elementeve të veçantë të sistemit financiar, por edhe nga ndërlidhjet dhe ndërveprimet e këtyre elementëve”. Këndvështrimi “makro” të çon pikërisht te ndërlidhjet midis ekonomisë reale dhe sferës financiare, te rreziku sistematik, i cili bën që çekuilibri dhe goditjet financiare të dëmtojnë rëndë veprimtarinë e ekonomisë reale. Tipari tjetër i politikave makroprudenciale është “karakterit i tyre parandalues” në kuptimin që, zbatimi i tyre duhet të ketë si efekt parandalimin e shfaqjes së çekuilibrave financiarë, të fenomeneve pro-ciklike apo rrezikut sistematik, duke kufizuar rritjen shumë të shpejtë të huadhënies dhe thëllimin e borxheve të agjentëve ekonomikë, si dhe rritjen e kapaciteteve përthithëse ndaj “goditjeve” të institucioneve e strukturave financiare.

Ndryshe nga sa mendohet në shumë raste, politikat makroprudenciale nuk ndërtohen për të menaxhuar krizat financiare kur ato shfaqen, por pikërisht për të shmangur shfaqjen e tyre. Analizat dhe eksperiencat e bankave qendrore në Europën Qendrore dhe Juglindore, në Eurozonë apo edhe më gjerë, dëshmojnë se, zbatimi eficient i politikave makroprudenciale varet nga tre elementë thelbësorë:

1. mënyra e qeverisjes së politikave makroprudenciale,
2. identifikimi i saktë i çrregullimeve në

Kredia **SME**

Jepini hapësirë Biznesit tuaj



 **UNIONBANK**
e hapur për biznes

Kredi për çdo fazë të biznesit

Telefona
falas  **0800 0800**

biznes@unionbank.al | www.unionbank.al

tregjet financiare dhe përcaktimi i instrumenteve të përshtatshme për eliminimin e tyre, dhe

3. kuptimi i mekanizmave të transmetimit dhe ndërveprimit me politikave të tjera ekonomike, veçanërisht me politikave monetare, buxhetore dhe mikroprudenciale.

1. MIRËQEVERISJA E POLITIKAVE MAKROPRUDENCIALE.

Përballë domosdoshmërisë së mirëqeverisjes qëndrojnë tre sfida të mëdha, që autoritetet bankare dhe financiare duhet të zgjidhin: (i) saktësimi i mandatit të politikave makroprudenciale, (ii) organizimi institucional i tyre dhe (iii) rregullat e qeverisjes së autoriteteve, që ngarkohen për të përcaktuar dhe zbatuar këto politika.

Mandati i politikave makroprudenciale duhet të përcaktojë në mënyrë të qartë e koherente, objektivat, funksionet dhe pushtetin e autoriteteve makroprudenciale. Objektivat duhet të jenë precizë, të arritshëm dhe mbi të gjitha, të matshëm. Në fushën e stabilitetit financiar, bankat qendrore, ministritë e financave, institucionet e specializuara apo ekspertët e fushës vazhdojnë të ndeshen më një vështirësi serioze, pasi: ende nuk ekziston një përkufizim i qartë dhe i pranuar gjerësisht për “përmbajtjen e stabilitetit financiar”, e më tej, i njëjti problem për ta shprehur dhe matur atë me anë të një treguesi të vetëm. Përmbajtja dhe struktura e raporteve të stabilitetit financiar që përgatisin bankat qendrore, apo ministritë e financave, është në zhvillim dhe plotësim të vazhdueshëm.

Organizimi institucional, në vende të ndryshme gjendet gjithashtu i zbatuar në forma dhe arkitektura të ndryshme. Autoritetet makroprudenciale variojnë në funksion të përfshirjes dhe integritetit të tyre institucional në bankat qendrore, në institucionet që kanë përgjegjësinë e kontrollit prudencial dhe politikave makroprudenciale, në ministritë e financave, etj.. Aktualisht, ende nuk ka ndonjë “model” që të konsiderohet më eficienti dhe i rekomandueshëm që zbatohet në shkallë të gjerë nga vende të ndryshme. Duke analizuar vende të ndryshme, eksperiencat janë të larmishme: në Republikën Çeke dhe Irlandë është Banka Qendrore ajo ku janë përqendruar funksionet mikro dhe makroprudenciale; në Britaninë e Madhe, Greqi, Hungari, Portugali, Kroaci, Hollandë, Poloni, etj., janë Bankat Qendrore pranë të cilave është asociuar një komitet i ngarkuar për politikave makroprudenciale;

në SHBA, Francë, Shqipëri, Austri, Bullgari, Gjermani, Itali, etj., janë bankat qendrore që e luajnë drejtpërdrejt rolin e autoritetit kryesor makroprudencial; në Suedi dhe Finlandë, banka qendrore nuk ka asnjë përgjegjësi makroprudenciale, duke e deleguar këtë funksion në një tjetër institucion mbikëqyrës, etj..



Tipari tjetër i politikave makroprudenciale është “karakterit i tyre parandalues” në kuptimin që, zbatimi i tyre duhet të ketë si efekt parandalimin e shfaqjes së çekuilibrave financiarë, të fenomeneve pro-ciklike apo rrezikut sistemik, duke kufizuar rritjen shumë të shpejtë të huadhënies dhe thellimin e borxheve të agjentëve ekonomikë, si dhe rritjen e kapaciteteve përthithëse ndaj “goditjeve” të institucioneve e strukturave financiare.



Megjithatë, pavarësisht formave të ndryshme të organizimit, synimet bazë janë: ruajtja e pavarësisë së bankave qendrore, evitimi i konflikteve midis politikave mikro dhe makroprudenciale, garantimi i koordinimit me politikave të tjera ekonomike, veçanërisht me ato monetare dhe buxhetore, pozicionimi i qartë i autoriteteve makroprudenciale në raport me kompleksitetin e objektivave të stabilitetit financiar, etj..

Menaxhimi dhe funksionimi i autoriteteve makroprudenciale. Në këtë aspekt, çelësi i suksesit konsiderohet “garantimi i autonomisë apo pavarësisë së politikave makroprudenciale” edhe kur ato janë jopopullore, apo të kontestueshme nga agjentët ekonomikë, bankat apo institucionet e tjera financiare e monetare. Rregullat e funksionimit duhet të përcaktojnë qartë dhe marrëdhëniet ndërmjet strukturave, apo institucioneve të ndryshme, që drejtpërdrejt apo tërthorazi kanë si objektivi stabilitetin financiar dhe kontribuojnë në përcaktimin e politikave makroprudenciale. Si raste tipike në këtë drejtim janë evidentuar bankat qendrore që kanë në ngarkim si politikave monetare, ashtu dhe ato makroprudenciale, ministritë e financave kur kanë në ngarkim si stabilitetin financiar, ashtu dhe autoritetin makroprudencial, etj..

2. IDENTIFIKIMI I ÇRREGULLIMEVE NË TREGJET FINANCIARE DHE PËRCAKTIMI I INSTRUMENTEVE PËR ELEMENIMIN E TYRE.

Nevoja për të identifikuar çrregullimet e tregjeve financiare bëhet e evidente, në kuadrin e ndërtimit të politikave makroprudenciale, pavarësisht vështirësive për të përcaktuar qartë objektivin e stabilitetit financiar. Ekspertët e fushës dhe institucionet e specializuara kanë përcaktuar një grup treguesish, që evidentojnë “çrregullimet” e tregjeve, si: rritja e shpejtë e huas, rritja e huave me probleme dhe borxheve të agjentëve ekonomikë, rreziku i likuiditetit të institucioneve financiare, rritja e nivelit të ekspozimit ndaj rrezikut, rritja e transaksioneve dhe produkteve derivative jashtë bilanceve, etj. Megjithatë, ndryshe nga sjellja tradicionale e politikave monetare, që mbështeten në “Parimin e Tinbergen”, që parashikon një instrument për çdo objektivi, në rastin e stabilitetit finan-





ciar po bëhet e domosdoshme përdorimi i njëkohshëm i shumë instrumenteve, për të arritur një objektiv të vetëm. Përvoja e viteve të fundit po tregon se, përdorimi i instrumenteve makroprudentiale mund të shfaqë efekte anësore në sistemin financiar, apo ekonominë në përgjithësi. Në këtë kontekst, rekomandohet që të analizohen dhe njihen sa më mirë kanalet e transmetimit të politikave makroprudentiale, çka nënkupton veç të tjerave, edhe studime analitike e solide mbi bashkëveprimin dhe efektet reciproke të politikave makroprudentiale me politikën e tjera stabilizuese të tregjeve financiare e monetare.

3. KANALET E TRANSMETIMIT DHE NDËRVEPRIMIT ME POLITIKAT E TJERA EKONOMIKE

Kriza financiare provokoi dhe një debat të madh në gjirin e ekonomistëve, financierëve dhe përgjithësisht në teorinë ekonomike, lidhur me problematikën e stabilitetit financiar. Autorë të ndryshëm pohojnë se: “në cilësinë e vendim-marrjes, aktualisht nuk disponohet një kuadër analitik i mjaftueshëm dhe solid, për të analizuar eficientësinë e politikave makroprudentiale dhe kuptimin e kanaleve të transmetimit të tyre”. Vështirësia kryesore qëndron në integrimin e llojeve të ndryshme të çrregullimit të tregjeve në fokusin e veprimit të një institucioni të vetëm financiar e makroprudencial. Në kontekstin aktual, në të cilin politikën monetare e kanë luajtur tashmë rolin e tyre në mbështetje të veprimtarisë

ekonomike dhe kur politikën buxhetore e kanë konsumuar stimulimin fiskal, duket se kanë mbetur vetëm politikën makroprudentiale, si të vetmet politika të afta që të përballojnë goditjet asimetrike. Për këtë arsye, megjithë ligjet dhe strukturat koordinuese të kontrollit në nivel evropian, apo ndërkombëtar, që garantojnë se masat makroprudentiale kombëtare të mos kenë efekte të padëshirueshme në vendet e tjera, “në vendet e Bashkimit Europian është miratuar një ligj i veçantë, që ju jep përgjegjësi të mëdha autoriteteve makroprudentiale kombëtare”.

Studime të shumta provojnë se problemi i ndërveprimit të politikave makroprudentiale me politikën e tjera ekonomike është mjaft i rëndësishëm. Përfshirja e bankave qendrore në këtë sferë duhet bërë në mënyrë të tillë që, zbatimi i politikave makroprudentiale të mos interferojë me politikën monetare dhe të reduktojë në maksimum konfliktin e objektivave të tyre, për arsye se kanalet e transmetimit të këtyre politikave janë të përafërta. Ndërveprimi me politikën buxhetore buron nga vetë natyra pothuajse fiskale që shfaqin disa instrumente makroprudentiale të tilla si: “taksat sistematike”, objektivi i të cilave është pagesa nga ana e institucioneve financiare e taksave proporcionale me kontributin e tyre në rrezikun sistematik. Këto instrumente e kanë bazën në transfertat apo në rishpërndarjen e burimeve ndërmjet agjentëve të ndryshëm ekonomikë. Në këtë kuadër, për të eliminuar konflikte që mund të çenojnë stabi-

litetin financiar rekomandohet që, midis politikave makroprudentiale dhe atyre buxhetore të realizohen vazhdimisht “marrëveshje mirëkuptimi dhe informacioni të ndërsjelltë”.

Përmbledhtazi, domosdoshmëria e artikullimit të politikave mikro e makroprudentiale me njëra-tjetrën paraqitet si një sfidat kryesore, në aspektin e shmangjes së “konfliktit të objektivave”. Parimet e reja themelore të miratuara në kuadër të Komitetit të Bazelit në shtator 2012, evidentojnë rëndësinë e konsolidimit të perspektivës “makroprudentiale”, d.m.th. përfshirjen e sistemit financiar në tërësinë e tij, në mbikqyrjen mikroprudentiale të bankave, në mënyrë që të kontribuojë në identifikimin, analizën dhe parashikimin e rreziqeve sistematike. Nga ky këndvështrim, duket se kemi të bëjmë me një ndryshim thelbësor të perspektivave të mbikqyrjes bankare, me synim të qartë minimizimin e konfliktit të objektivave ndërmjet politikave të ndryshme. Edhe në këtë aspekt, kriza e fundit financiare na mësoi se “kur ekzistojnë konflikte të tilla, është e nevojshme t’i jepet përparësi politikave makroprudentiale, të cilat absorbojnë më lehtë rreziqet me pasoja makroekonomike dhe sociale”.

Si përfundim, mund të pohohet se, “komplimentariteti, ndërthurja dhe hierarkizimi i objektivave, janë tre parimet bazë që duhet të na udhëheqin për të garantuar efekte maksimale, në koordinimin e politikave makroprudentiale me ato monetare, buxhetore dhe mikroprudentiale”.

SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE (AAB) ◀

AAB dhe bankat anëtare, në situatën urgjente të krijuar nga përmytjet në jug të Shqipërisë, ofruan mbështetjen e tyre, veçanërisht aty ku dëmet ishin më të mëdha.

Më konkretisht, në shkurt, AAB kontribuoi në shumën 6 milionë lekë, në ndihmë fermerëve dhe familjeve të prekura nga kjo fatkeqësi natyrore, përpos nismave individuale të bankave anëtare, të cilat treguan solidaritetin e tyre me familjet e prekura dhe me autoritetet e angazhuara në përmirësimin e situatës së krijuar.



ALPHA BANK ALBANIA ◀

Alpha Banka Albania ndërmori gjatë tremujorit të parë të 2015-ës disa nisma me karakter social, si:

- Sponsorizim i Fondacionit Spitalor "Nëna dhe Fëmija",
- Donacion prej 10,000 euro dhe 23 pako me artikuj ushqimorë dhe industrialë, në ndihmë të familjeve të prekura nga përmytjet në jug të vendit,
- Sponsorizim i Galerisë "Kalo ART",
- Sponsorizim i veprimtarisë festive, organizuar nga Ambasada Greke, me rastin e festës kombëtare të Greqisë, 25 Mars 2015.

BKT ◀

Donacion për familjet e prekura nga përmytja në jug të vendit

Banka Kombëtare Tregtare tregoi solidaritetin e saj me familjet e prekura nga përmytjet në jug të Shqipërisë. Nisur nga emergjenca në trajtimin e dëmeve të shkaktuara dhe brenda kuadrit të politikës së saj të përgjegjshmërisë sociale, lidhur me fatkeqësitë natyrore, BKT dhuroi shumën prej 50.000 euro, për familjet më të prekura në këtë rajon.



CREDINS BANK ◀

Gjatë tremujorit të parë 2015, Credins Bank ka kontribuar në këto fusha:

• Mjekësi

Banka investoi në Spitalin Rajonal Durrës për plotësimin me kite laboratorike të laboratorit të spitalit, si dhe në Spitalin Nr. 5 të Tiranës për përmirësimin e kushteve të punës.

• Arsimit

Banka mbështeti ndërtimin e laboratorit të fizikës në gjimnazin "Petro Nini Luarasi".

• Mjedis

Banka investoi në gjelbërimin e një zone pranë Laprakës.

• "Java e Rinisë 2015"

Credins Bank mbështeti eventin pesëditor me rastin e "Javës së Rinisë 2015" organizuar nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, si dhe iniciativat dhe idetë e të rinjve dhe shumë aktivitete kulturore gjatë javës, si shfaqje filmash, diskutime, debate dhe çështje që shqetësojnë aktualisht rininë shqiptare.



FIBANK ALBANIA



Solidare për Shqipërinë

Për shkak të përmbytjeve nga rreshjet e shumta të shiut dhe në kuadër të dhurimeve, që Fibank akordon çdo vit për çështje të caktuara sociale, banka dhuroi një shumë të konsiderueshme ndihmash humanitare për banorët e prekur më shumë në Vlorë, Fier, Berat dhe Gjirokastrë. Fondi i vënë në dispozicion, u menaxhua nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe më saktë nga Shërbimi Social Shtetëror dhe u vlerësua nga Kryeministri dhe Ministri Veliq.



Fushatë sensibilizuese për Dhurimin e Gjakut

Për tu ardhur në ndihmë të njerëzve që kanë nevojë për transfuzion gjaku, FIBANK Albania në bashkpunim me Kryqin e Kuq Shqiptar organizoi në ambientet e zyrave qendrore fushatën për dhurim vullnetar të gjakut nga punonjësit e saj.



INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA



Dhurime të stafit për familjet e përmbytura në zonat e jugut

Me nismën e Drejtueses së Divizionit të Operacioneve pranë Intesa Sanpaolo Bank Albania, stafi i bankës mbledhi një shumë të konsiderueshme parash, që u përdorën për të blerë batanije për banorët e zonave të përmbytura në jug të vendit. Kjo nismë, tërësisht vullnetare, u mbështet nga shumë kolegë, të cilët dhuruan gjithashtu veshje të ngrohta për fëmijë e të rritur, për të lehtësuar sadopak përditshmërinë e këtyre banorëve, në javët e para pas përmbytjeve.

Ndihmë në pajisje të teknologjisë së informacionit për zyrat lokale të institucioneve

Banka, duke pasur në fokus nevojat specifike të qyteteve e lokaliteteve ku operon, ndihmoi me disa pajisje të teknologjisë së informacionit zyrën e

OSSHE-së në Gjirokastrë dhe Zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm, në Fier.

Festa e Karnavaleve për Fëmijë, një vlerë e shtuar në raportin Punë - Jetë private

Banka organizoi Festën e Karnavaleve për Fëmijë, e kthyer në traditë përgjatë 4 viteve të fundit, duke theksuar edhe një herë rëndësinë që ajo i jep ekulibrit të artë midis punës e jetës sociale e familjare të një prej grupimeve më të qënësishëm të bashkëpunëtorëve të saj afatgjatë: punonjësve të saj. Kjo festë u dha mundësinë fëmijëve, të veshur sipas personazheve të tyre të parapëlqyer, të luanin e argëtoheshin në shoqërinë e animatorëve profesionistë e maskotave, si dhe të mësonin e shijonin patinazhin në akull në një pistë të rezervuar vetëm për ta, në mjediset e njëres prej Qendrave Tregtare të Tiranës.



PROCREDIT BANK



Nxitja e bashkëpunimit midis bizneseve rajonale

Biznese nga Shqipëria dhe Serbia u ftuan në një takim të përbashkët rajonal, të organizuar në qytetin e Tiranës. Në fokus të takimit ishte nxitja dhe zhvillimi i marrëdhënieve rajonale të biznesit midis bizneseve, të cilët operojnë në Shqipëri dhe Serbi. Të pranishëm në takim ishin rreth 80 biznese nga industria e ushqimit, të sektorëve të prodhimit, shpërndarjes, si dhe të shërbimit. ProCredit Bank, thekson se do të vazhdojë të ofrojë mbështetje maksimale për klientët e saj, duke zbatuar praktikat më të mira gjermane të bankimit. Vitin e kaluar grupi ProCredit filloi me organizim e veprimtarive të tilla për bizneset dhe ky takim është i pesti takim në rajon, organizuar nga Bankat ProCredit, i cili pason takimin e mbajtur në Prishtinë dhe të tjerat të mbajtura më herët në qytete si: Tiranë, Nish dhe Strugë.



RAIFFEISEN BANK ALBANIA



Raiffeisen Bank sponsorizon të parën qendër rinore në Shqipëri

Raiffeisen Bank mbështeti ngritjen e qendrës së parë rinore në Shqipëri, një nismë kjo e Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, për ngritjen e qendrave rinore në të gjithë Shqipërinë. Hapja e këtyre qendrave ka si synim ofrimin e mjediseve dhe programeve specifike, që ndihmojnë në kultivimin e individëve produktivë për shoqërinë dhe të ardhmen e tyre. Në ceremoninë e përirimit të kësaj qendre ishin të pranishëm: Z. Christian Canacaris, Drejtori i Përgjithshëm i Raiffeisen Bank, Z. Edi Rama, Kryeministër i Shqipërisë, Z. Erjon Veliaj, Ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, të rinj e të reja nga shkollat e kryeqytetit, etj.



Raiffeisen Bank dhuron pajisje elektroshtëpiake për familjet e dëmtuara nga përmbytjet në jug të vendit

Raiffeisen Bank, duke parë situatën e rëndë të familjeve të dëmtuara nga përmbytjet në jug të vendit vendosi t'i bashkohet nismës së Qeverisë Shqiptare, për të kontribuar në ndihmë të këtyre familjeve. Meqenëse një bankë që i shërben komunitetit dhe e angazhuar maksimalisht për përgjegjësinë e saj sociale, Raiffeisen Bank dhuroi pajisje elektroshtëpiake në një vlerë prej 10,000 euro, për t'i ardhur në ndihmë këtyre familjeve të dëmtuara.



Raiffeisen Bank financon sallat e pritjes në komisaritet e policisë së Tiranës

Drejtori i përgjithshëm i Raiffeisen Bank, Z. Christian Canacaris, së bashku me Ministrin e Brendshëm, Z. Saimir Tahiri, përiruan sallën e pritjes me qytetarët në mjediset e Komisarariatit të Policisë nr.1 në Tiranë. Këto mjediset të rehabilituara do të ofrojnë kushte moderne dhe me standarde të larta për qytetarët e Tiranës. Ky përirim mbyll edhe projektin për rehabilitimin e sallave të pritjes me qytetarët në Komisaritet e Policisë nr.1, 3, 4 dhe 5 në Tiranë, të realizuara me financimin e Raiffeisen Bank.





UBA Banka e Bashkuar
e Shqipërisë
United Bank
of Albania

FINANCIME | DEPOZITA
TRANSFERTA | PAGESA



BANKA JUAJ UNIKE!

www.uba.com.al
Tel: 00 355 4 2404575

Përgjegjshmëria sociale

SOCIETE GENERALE ALBANIA

Kontribuoi duke pajisur 30 familje në fshatin Frakull me: dyshekë, jastëkë, çarçafë, batanije dhe ushqime. Në bashkëpunim me “Qendrën Vullnetare të Emergjencave Civile”, vullnetarë nga Societe Generale Albania udhëtuan drejt Frakullës, për të ndihmuar në shpërndarjen e këtyre ndihmave të familjet.



VENETO BANKA

Partner Financiar i QKP-së në Milano EXPO 2015

Qendra Kombëtare e Panaireve (QKP), në varësi të Ministrisë së Ekonomisë, është institucioni i cili organizon për të dytin vit rradhazi Edicionin e Panaireve Lëvizëse në Shqipëri. Partner Financiar i QKP-së po për të dytin vit rradhazi ishte Veneto Banka, duke rrugëtuar së bashku kudo ku organizohen panaire. Pjesë e programit të QKP-së gjatë këtij viti është edhe MILANO EXPO 2015, ku pavioni i Shqipërisë pritet të ngjallë interesin e vizitorëve të shumtë nga e gjithë bota.



Në ndihmë të dentistëve të rinj

Banka ka mbështetur vazhdimisht studentët e rinj, kryesisht ata të arsimit pro-

TIRANA BANK

Tirana Bank përfaqon nismën: “Solidariteti Albania”

Tirana Bank, duke iu përgjigjur menjëherë thirrjes për veprim diskutuar me kryeministrin e Shqipërisë, z Edi Rama, filloi një fushatë ndërgjegjësimi lidhur me përmbytjet që ndodhën gjatë muajve janar e shkurt, në Shqipërinë e Jugut. Në përgjigjen e saj, për të mbështetur njerëz të prekur nga përmbytjet, Tirana Bank nëpërmjet projekteve të saj të Përgjegjësive Sociale të Korporatës, dhuroi 50.000 euro, si dhe hapi për këtë arsye llogari bankare, për të mundësuar dhe individët të dhurojnë për këtë qëllim.

“Java e Parasë” në Universitetin European të Tiranës

Tirana Bank mbështeti një nga veprimtaritë e organizuara nga AAB në kuadër të Javës së Parasë. Në veprimtarinë e organizuar me studentë të degës “Financë” të Departamentit të Financës në Univeersitetin European të Tiranës (UET), Tirana Bank akordoi një çmim simbolik prej 50.000 lekësh, për pesë studentet fituese të konkursit: “Sikur të ishim bankierë”, në formën Kartave të Debitit për studentë. Për më tepër, për të 10 studentet pjesëmarrëse në konkurs u shpërndanë Karta Debiti Studentore nga Tirana Bank.

fesional. Në bashkëpunim me “Dental Leader Corsi”, një qendër profesionale dentare banka ofron bursa studimi për studentët e stomatologjisë si dhe kreditimin me financime të favorshme për hapjen e kabineteve të reja dentare nga ana e këtyre studentëve.



Veneto Banka dhe Dental Leader Corsi



Banka dhe studentët e Institutit Kulinar “Neranxi”

Veneto Banka ofroi bursa studimi për studentët e Institutit Kulinar “Neranxi”, falë marrëveshjes që ka nënshkruar kohë më parë me këtë institucion formimi profesional, si dhe do të kreditojë bizneset e reja nga ana e këtyre studentëve.



Veneto Banka dhe Institutit Kulinar “Neranxi”



nga Z. Nikolin KOLA

Konsulent i pavarur i teknologjisë së informacionit

SFIDA E BIZNESIT ONLINE

Shumë biznese që përdorin teknologjinë informacionit në komunikimin me konsumatorët, i kanë zhvendosur shërbimet e tyre online, për një përdorim më me lehtësi të tyre nga konsumatorët. Dyqanet e shitjes me me pakicë venë në dispozicion një inventar të plotë online për konsumatorët që duan të bëjnë blerje. Bankat u ofrojnë mundësinë klientëve që të paguajnë faturat, kontrollojnë bilancin e llogarisë, e madje edhe të aplikojnë për hua, në mënyrë online. Shoqëritë e sigurimeve i japin mundësi të siguruarve të depozitojnë pretendimet e tyre, të kontrollojnë statusin e policave që zotërojnë, ose të kontrollojnë politikat e mbulimit me sigurim, në mënyrë online. Ofrimi i këtyre shërbimeve online e ka përmirësuar ndjeshëm efikasitetin e tyre, duke u mundësuar konsumatorëve kryerjen e transaksioneve rutinë në mënyrë komode, nëpërmjet pajisjeve të lidhura me internetin, ndërkohë që janë të angazhuar në përmbushjen e punëve dhe detyrave të tyre të përditshme.

Vendosja e kontaktit njerëzor në bankingun online

■ ■ Në epokën e sotme digjitale bizneset online janë në kërkim të mënyrave novatore që risjellin kontaktin personal, i cili ekziston në dyqanet e tradicionale, e ta përfshijnë atë në përvojën e tyre online. Pra, ata i duan njëkohësisht të dyja, eficiencën dhe komoditetin e komunikimit online, por me shërbimin e klientit dhe marrëdhënien personale, që ofron prania e njësisë fizike të shërbimeve dhe shitjeve.

Komoditeti i shërbimeve online shoqërohet dhe me kostot përkatëse. Humbja e kontaktit njerëzor dhe marrëdhënies personale me konsumatorin janë disa nga kostot kryesore të shërbimeve online. Ofrimi i shërbimeve nëpërmjet internetit e drejton klientin drejtpërdrejt në një faqe interneti, ku komunikimi është jo-personal, shpesh jofleksibël dhe në disa raste i paaftë për të trajtuar të gjitha nevojat e konsumatorëve.

Pavarësisht se shoqëritë shpesh kanë qendrat e tyre telefonike dhe të komunikimit online të dedikuara për kujdesin ndaj klientit, mënyrave të tilla të komunikimit i mungojnë ndjesorët e nevojshëm vizualë, për të matur nivelin e pakënaqësisë së konsumatorëve, për të kapur detajet e

■ ■ Komoditeti i shërbimeve online shoqërohet me kostot përkatëse. Humbja e kontaktit njerëzor dhe marrëdhënies personale me konsumatorin janë disa nga kostot kryesore të shërbimeve online.

vlefshme që mund të ndihmojnë në zgjidhjen e problemeve të klientit, ose t'u japë atyre këshillat e duhura. Gjithnjë e shumë biznese online janë në kërkim të mënyrave novatore, që rivendosin kontaktin personal, i cili ekziston në dyqanet e tradicionale, e ta përfshijnë atë në përvojën e tyre online. Pra, ata i duan njëkohësisht të dyja, eficiencën dhe komoditetin e komunikimit online, por me shërbimin e klientit dhe marrëdhënien personale, që ofron prania e njësisë fizike të shërbimeve dhe shitjeve.

SHËRBIMET FINANCIARE PËRMES VIDEOS

Bota e financave tashmë jeton dhe merr frymë online. Çdo ditë, gjithnjë e më shumë transaksione kryhen online; klientët sot janë thjesht shumë të zënë për të vizituar institucionet financiare, për kryerjen e transaksioneve të biznesit. Me qëllim që të investojnë, marrin hua apo menaxhojnë portofolet e tyre me besim, ata presin të shërbehen nga një shoqëri shërbimesh financiare që të jetë e arritshme, t'i ofrojë konsulencë dhe ekspertizë të menjëhershme, si dhe vijueshmëri në marrjen e vendimeve dhe menaxhimin e pasurisë.

Vidyo Inc, një firmë amerikane, lider e teknologjisë së komunikimeve audiovizuale, ofron një zgjidhje që plotëson hendekun ndërmjet komoditetit të komunikimit



online dhe komunikimit ballë për ballë me klientin. Përdorimi i teknologjisë së Vidyo-s u jep bizneseve online të gjitha mjetet e nevojshme për të ofruar cilësi të lartë, lehtësi komunikimi me klientët e tyre, duke përmirësuar kështu përvojën dhe kënaqësinë e klientit. Platforma e Vidyo-s mundëson ofrimin e shërbimeve të klientët përmes videos dhe integrohet lehtësisht me infrastrukturën, aplikacionet dhe rrjedhën e punës së shërbimeve financiare.

Lojtarët kryesorë të industrisë financiare, si: Barclays, IndusInd, Raiffeisen, Merrill Lynch, etj, janë mbështetur në teknologjinë e Vidyo-s për t'ju përgjigjur këtyre sfidave dhe përdorin platformën e saj për të ofruar shërbime financiare përmes videos, gjë që kultivon një marrëdhënie më të qëndrueshme dhe më të forta me klientët.

NDËRTIMI I BESNIKËRISË ME MË SHUMË SHËRBIME PERSONALE ONLINE

Platforma e Vidyo-s mund të përdoret duke i shtuar një kanal video sistemit ekzistues të qendrës së kontaktit, ose mund të përdoret veçmas, për të krijuar një modul video ndihme në kohë reale, që ndërtohet brenda një faqe interneti. Nëpërmjet qendrës së kontaktit me video, organizatat financiare mund të sigurojnë një sërë përfitimesh, si:

Ofrimi i qasjes drejt ekspertëve - Kur nevojitet ndihma e një eksperti të fushës për të trajtuar nevojat e klientit, gjëja më e shpejtë dhe e më e përshtatshme është përfshirja e një eksperti. Kjo zgjidh çështjen e klientëve shpejt dhe rrit kënaqësinë e klientit.

Rritje e besnikërisë - Marrëdhëniet janë kyçi për besnikërinë e klientit. Shërbimet video mund të përdoren për të siguruar ndërveprim personal shumë të ngushtë, të nevojshëm për të krijuar dhe mbajtur marrëdhënie të forta me klientët më të rëndësishëm, që rezultojnë në besnikëri të fortë ndaj markës.

Rritje e Eficiencës - Koha është flori, kur bëhet fjalë për operacionet e qendrave të kujdesit ndaj klientëve. Koha më e shkurtër e ndërveprimit barazohet me kursimet në kosto dhe me klientë më të lumtur.

Platforma Vidyo për qëndrat e kontaktit:

- Portal Interneti me hyrje të menjëhershme në konsultime të sigurta video HD me bankierin personal.
- Mundësinë për të përfshirë ekspertë dhe burime të fushës, në çdo moment gjatë konsultimeve video.
- Mundësinë për t'u lidhur me një këshilltar investimesh për takime të programuara, thjesht nëpërmjet klikimit mbi një link web.
- Një mënyrë komode për të parë dhe riparë përmbledhjet dhe raportet e llogarisë së portofolit, gjatë takimeve online.
- Transaksione më të shpejta, duke përdorur programin e nënshkrimit elektronik.
- Komunikim video nga çdo shfletues Interneti, duke përdorur çdo lloj pajisjeje të lëvizshme, ose desktop dhe një lidhje të thjeshtë Interneti.
- Qasje në konsultime të regjistruara dhe të arkivuara, prezantime të analistëve dhe burime të tjera, për referencë të mëvonshme.

Meqenëse 70% e komunikimit njerëzor është vizual, qëndrat e kontaktit përmes videos mundësojnë komunikim më eficient dhe efektiv, që çon në zgjidhje më të shpejtë të problemeve dhe në një kohë të reduktuar ndërveprimi për çdo agjent.

Mundësi për rritjen e shitjeve - Ndërveprimet ballë për ballë sigurojnë mundësinë për të ofruar produkte dhe shërbime shtesë për të klientët. Aftësia për të demonstruar produktet, ndarë dokumentet dhe udhëzuar klientët, e kombinuar me një shërbim shumë të personalizuar, karakteristike kjo për ndërveprimin ballë për ballë, krijon mjedisin optimal për rritjen e shitjeve.

Sigurimi i një bashkëveprimi video në kohë reale (online) me klientët pasuron eksperiencën e klientit me shërbim ofruesin, duke krijuar besim dhe besnikëri ndaj markës. Përdorimi i platformës Vidyo, mundëson ofrimin e shërbimeve video ndaj klientëve brenda pak javëve, pa pasur nevojën e ekspertizës së brendshme për teknologjinë video. Lehtësia dhe komoditeti në përdorim bëjnë të mundur përshtatjen e shpejtë të stafit. Punonjësit aftësohen shpejt dhe nuk ekziston asnjë faktor shqetësues për klientët që ndërveprojnë përmes videos. Ata thjesht klikojnë, hyjnë në komunikim dhe kanë një ndërveprim shumë personal dhe efektiv me profesionistët e kujdesit ndaj klientit të shërbim ofruesit.

Vidyo Inc. është shoqëria lider e platformave të komunikimit audiovizual, me një gamë zgjidhjesh të larmishme për bizneset e vogla, të mesme dhe të mëdha, për sektorin financiar, shëndetësor, edukimit si dhe shërbimet publike. Vidyo është shoqëria pioniere e Telepranisë Personale, duke ofruar mundësinë e komunikimeve audiovizuale shumëpälëshe në çdo pajisje (tablet, smartphone, desktop, laptop), duke përdorur çdo rrjet komunikimi (ADS/Wireless/3G/4G) si dhe reduktimin së kostove nëpërmjet përdorimit të teknologjisë "cloud". Vidyo është zotëruese e më shumë se 80 patentave, si dhe më shumë se 65 familje patentash që janë në pritje, në juridiksione të ndryshme ndërkombëtare. Për më shumë vizitoni www.vidyo.com.

Communication Progress Sh.p.k. është një shoqëri e autorizuar dhe me ekperiencë në vënien në zbatim të platformave Vidyo. Communication Progress sjell më shumë se pesëmbëdhjetë vite eksperiencë në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit - TIK. Duke qenë të pozicionuar si ofrues zgjidhjesh të integruara horizontalisht e vertikalisht TIK, shoqëria synon që në mënyrë të vazhdueshme t'i mundësojë rajonit qasje në teknologjitë më të avancuara, nëpërmjet vendosmërisë për cilësi dhe mbështetjes për inovacion.



nga **Z. Erion MAXHARI**

Drejtor i Departamentit të Kartave
FIBANK ALBANIA

Termi “tregti elektronik” përkufizon aktin e shitjes së mallrave ose shërbimeve nga ana e bizneseve nëpërmjet pajisjeve elektronike si: kompjuter ose telefon dhe këtu do të përmenden vetëm blerjet nëpërmjet telefonit. Mbetet i rëndësishëm fakti që rritja globale e numrit të telefonave të zgjuar (smart) dhe penetrimi i tyre global, por edhe penetrimi në Shqipëri, po merr përmasa të mëdha. Pavarësisht se tregtia online ka edhe forma të tjera pagesash, si p.sh.: pagesa me transfertë bankare, karta të parapaguara, ose palë të tjera si agjenci transfertash, këtu do të trajtohen pagesat me kartë bankare në tregtinë online, e cila po transformohet në një trajtë të re përdorimi, duke kaluar nga kompjuteri ose laptop-i në telefona të zgjuar dhe tabletë.

Blerjet me kartë bankare nëpërmjet telefonit të zgjuar, në shumë raste, mund të jenë pothuajse të njëjta me blerjet që kryhen nga kompjuteri, pra procesi standard i blerjes duke vendosur të dhënat e kartës, si:

Pagesat me kartë nëpërmjet telefonave të zgjuar

Rëndësia në tregtinë elektronike



Teknologjia e pagesave nëpërmjet telefonave tashmë ka mbërritur edhe në Shqipëri dhe besojmë se kjo teknologji do vazhdojë të jetë në fokus edhe në dhjetëvjeçarin e ardhshëm.



numri i kartës, emri mbiemri i klientit, data e maturimit si dhe kodi unik i sigurisë tre shifror, që gjendet në anën e pasme të kartës.

Atëherë, ku qëndron ndryshimi i një blerjeje nëpërmjet telefonave të zgjuar nga një blerje normale në kompjuter? Përgjigja e kësaj pyetje është e ndërlikuar, pasi format e reja të përdorimit të kartave për blerje nga pajisjet e lëvizshme po evoluon çdo ditë në mënyra të ndryshme. Tashmë, me teknologjitë e reja blerjet nga telefonat e zgjuar mund t'i ndajmë në 3 mënyra:

- Blerjet standarde, duke vendosur të dhënat e kartës, njëjloj si në kompjuter,
- Blerjet ku të dhënat e kartës ruhen në llogarinë e shitësit,
- Blerjet ku të dhënat e kartës ruhen në një aplikacion, ose në një “portofol virtual”.

Zakonisht faqet e internetit mobile ose dhe vetë aplikacionet mobile bëjnë të mundur që përdorimi të jetë sa më i lehtë për konsumatorin dhe gjithashtu aplikacionet e ndryshme mobile rrisin ndjeshëm besnikërinë e klientit, duke i ofruar më shumë ulje dhe oferta të ndryshme. Së bashku me rritjen e teknologjive, por edhe transmetimin dhe ruajtjen e të dhënave, është e mundur që faqet mobile dhe aplikacionet të ruajnë të dhënat e kartës në mënyrë të sigurtë. Vendosja e të dhënave të kartës në çdo blerje është jo vetëm një proces disi i lodhshëm, por mbi të gjitha një veprim jo i sigurtë. Në këtë mënyrë

përdorimi vetëm i një fjalëkalimi, në vend të shumë të dhënave të kartës, bën të mundur që procesi i blerjes nëpërmjet telefonave të zgjuar të jetë më i thjeshtë, por gjithashtu edhe më i sigurt. Sipas statistikave të fundit



Termi “wallet” merr kuptim edhe më të rëndësishëm në përdorimin në telefonat e zgjuar, duke qenë se të gjitha kartat e kreditit që një klient zotëron mund të përdoren nga një portofol i vetëm dhe nuk është më e nevojshme të mbahen mend të gjitha të dhënat e kartës. Mjafton pajisja e llogarisë së “portofolit virtual” me një emër përdoruesi dhe një fjalëkalim, e më pas, të gjitha kartat që zotëron klienti janë të konsultueshme dhe përdorueshme nga ky portofol.



vihet re që komoditeti që ofron blerja me kartë nëpërmjet telefonave të zgjuar është shumë i madh dhe ka sjellë jo vetëm rritje të vëllimit të blerjeve, por edhe të besnikërisë së klientit, duke shpenzuar edhe më shumë.

Rritja e këtij fenomeni vjen për disa arsye, të cilat lidhen ngushtë me zgjerimin e qasjes së popullatës në internet nëpërmjet telefonave të zgjuar, si dhe me zhvillimet e rëndësishme në teknologjitë e aplikacioneve. Shkaqet kryesore që ky fenomen po tregon një eficiencë më të lartë sesa blerjet në kompjuter, mund të jenë:

- Numri i lartë i përdoruesve të telefonave të zgjuar, si dhe përdorimi i tyre gjatë gjithë ditës, bën të mundur që koha e shpenzuar online të jetë më e madhe, krahasuar me kohën e kaluar në kompjuter,
- Blerësit kanë më shumë lehtësi gjatë blerjes, pasi telefoni i zgjuar ofron blerje online në momentin që nevojitet, si edhe është më lehtë i aksesueshëm sesa një kompjuter personal,
- Ofrohet më tepër siguri, pasi mendohet që telefoni i zgjuar përdoret nga vetë klienti, ndërkohë që edhe viruset, “malware”-t, etj., janë më të pakët në këto lloj telefonash, krahasuar me kompjuterat,
- Gjatë përdorimit të këtyre telefonave ofrohet më tepër ndërveprim dhe mundësi të njoftime “push notification”, me anë të të cilëve klientët njoftohen për okazione, ose ulje të ndryshme. Informacioni që firmat përfitojnë nëpërmjet këtyre telefonave është më i lartë sesa ai që përfitohet nëpërmjet kompjuterit.

Por si ruhen të dhënat e kartës dhe si përdoren ato më pas për blerje online? Me telefonat e zgjuar, që kanë në vetvete edhe mundësi enkriptimi, është e thjeshtë dhe e sigurt ruajtja e të dhënave konfidenciale të kartës. Shumë shoqëri të mëdha që shesin online ofrojnë mundësinë që, gjatë hapjes së llogarisë nga këta telefona, mund skanohen të dhënat e kartës duke u përdorur kamerat e aparatit dhe nga ky skanim merren automatikisht këto të dhëna. Kjo është një lehtësi për kartëmbajtësin, pasi sa herë që nevojitet të kryejë një blerje nuk duhet të nxjerrë kartën nga portofoli, por të dhënat e kartës janë të ruajta në llogarinë e tij pranë shitësit, ose këto të dhëna ruhen edhe në një aplikacion në vetë telefonin e klientit.

Ndërkohë termi “wallet” merr kuptim edhe më të rëndësishëm në përdorimin në telefonat e zgjuar, duke qenë se të gjitha kartat e kreditit që një klient zotëron mund të përdoren nga një portofol i vetëm dhe nuk është më e nevojshme të mbahen mend të gjitha të dhënat e kartës. Mjafton pajisja

Telefonat e zgjuar dhe interneti janë mjeti kryesor që ka ndihmuar tregtinë online. Kartat bankare do vazhdojnë të jenë gjithashtu baza e pagesave nëpërmjet telefonave, por edhe ato do të evoluojnë në forma të tjera, ku një prej tyre duket që do të jete “portofoli” virtual.

e llogarisë së “portofolit virtual” me një emër përdoruesi dhe një fjalëkalim, e më pas, të gjitha kartat që zotëron klienti janë të konsultueshme dhe përdorueshme nga ky portofol. Procesi është i tillë që, shoqëria që ofron këtë shërbim lidhet me shumë shitës të tjerë, duke ofruar që ata të shesin mallrat/shërbimet e tyre, nëpërmjet përdorimit të sistemit “wallet”, që kjo shoqëri ka. Disa nga këta shoqëri, si p.sh.: PayPal ose Scryll, ofrojnë lidhje me shumë tregje online si: eBay, Amazon, etj, dhe krijojnë lidhje të drejtpërdrejta me këto faqe dhe gjatë procesit të pagesës “check out”, ku për të paguar për mallin e blerë duhet të vendosësh të dhënat e përdoruesit dhe fjalëkalimin e

faqes. Procesi është mjaft i thjeshtë, sidomos për ata persona të cilët zotërojnë karta bankare, nga banka të ndryshme. Portofoli virtual ofron mbajtjen dhe menaxhimin e këtyre kartave nga një llogari, duke ofruar edhe shërbime shtesë. një prej këtyre shërbimeve është edhe lajmërimi i klientit kur një nga këto karta po i afrohet datës së maturimit. Mendohet që në një të ardhme të afërt këto “portofole” do zënë një vend edhe më të madh në tregtinë online, për shkak të efikasitetit të madh që kanë, por edhe sepse ofrojnë një fleksibilitet për të gjitha palët që marrin pjesë në tregtinë elektronike.

Pagesat me kartë nëpërmjet telefonit kanë arritur majat, sidomos gjatë vitit të fundit ku tregtia online B2C (nga biznes në konsumator) ka arritur në nivelin e 1,500 miliardë dollarëve, nga 1,000 miliardë dollarë që ka qenë në vitin 2012 (vetëm pagesat përmes telefonave të zgjuar dhe tableteve, zë mbi 20% të totalit). Duket qartazi që telefonat e zgjuar dhe interneti janë mjeti kryesor që ka ndihmuar tregtinë online. Kartat bankare do vazhdojnë të jenë gjithashtu baza e pagesave nëpërmjet telefonave, por edhe ato do të evoluojnë në forma të tjera, ku një prej tyre duket që do të jete “portofoli” virtual. Një gjë është e sigurt që, tani dhe në të ardhmen e afërt, gjithnjë e më shumë konsumatorë dhe kartëmbajtës do të jenë të prirur për të përdorur kartat e tyre edhe më shpesh nëpërmjet telefonave të zgjuar.





TË STUDIOSSH NË ITALI

Për të gjithë studentët që dëshirojnë të studiojnë në Universitetet Italiane, Veneto Banka ju ofron:

- Financim afatshkurtër dhe afatgjatë të studimeve
- Depozitim e Garancisë Bankare (sipas procedurave për aplikimin për Vizë në Ambasadën Italiane)
- Transferta Bankare drejt Italisë me kushte preferenciale

Veneto Banka. Banka që beson tek ju.

Edukimi Financiar 2015

JAVA E PARASË (9-13 MARS 2015)

Edhe këtë vit, Shqipëria ishte pjesë e veprimtarive të organizuara në mbarë botën, në kuadër të Javës së Parasë, që synon ndërgjegjësimin e të rinjve për menaxhimin e parasë, kursimeve dhe ardhurave, që në moshë të re. Këtë vit u organizuan njëkohësisht Java Europiane e Parasë, për herë të parë nën koordinimin e Federatës Europiane Bankare, dhe Java Globale e Parasë, nën koordinimin e organizatës "Child and Youth Finance International (CYFI)".

AAB bashkëpunoi këtë vit me Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, në organizimin e disa veprimtarive edukuese mbi financat për fëmijë dhe të rinj.

VEPRIMTARI TË ORGANIZUARA:

9 Mars

Debat mbi Financat Personale për gjimnazistët
Java e Parasë u hap me një aktivitet në Qendrën Rinore në Tiranë, ku përfaqësues të AAB, Ministrisë dhe bankave diskutuan me të rinjtë mbi rëndësinë e edukimit financiar dhe produkteve bankare specifike.



11 Mars

Shfaqja e Teatrit me Kukulla "Çufo dhe Tipi - Një aventurë me verdhushka"
Në Teatrin Kombëtar të Kukullave u shfaq për nxënësit e klasave të para të shkollave 9-vjeçare të Tiranës, pjesa teatrale, bazuar në paketën "1,2,3... Derrkuçi Çufo mëson të kursejë".



Seminar mbi Skemën e re të Fondeve të Pensioneve
Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë prezantoi në mjediset e Qendrës Rinore Tiranë skemën e re të pensioneve për studentët e gjimnazeve.



10 Mars

Vizita në Degë Bankë
Nxënësit e shkollës së mesme Teknike Ekonomike vizituan degën e një banke tregtare për të vëzhguar nga afër operacionet që kryhen gjatë një dite pune në bankë.



12 Mars

Seminar "Startup Life Tirana"
Në Qendrën Rinore të Tiranës u organizua workshopi interaktiv nga Startup Live Tirana, me temë hapjen e një biznesi prej të rinjve.



Leksion në Klubin e Studentëve të Ekonomisë,
Në bashkëpunim me Klubet Studentore u organizuan orë seminary me studentët të Fakultetit Ekonomik, mbi normat e interesit dhe kategorizimin e kredive.



Quizz "Testoni njohuritë tuaja mbi Financat dhe Bankat" në faqen FB të AAB-së

Ndjekësit e faqes Facebook të AAB, testuan njohuritë e tyre mbi financat dhe sistemin bankar. Çdo ditë të Javës së Parasë, u përzgjodhën 10 fitues, të cilëve i'u dha një çmim simbolik, botim special i AAB-së: "Historiku i Bankave në Shqipëri".



Video mbi "Kreditë Konsumatore" në faqet në FB e YouTube të AAB-së



13 Mars

Seminar me Studentët e Ekonomisë në UET
AAB, në bashkëpunim me Departamentin e Financës të Fakultetit Ekonomik të UET-së zhvilloi aktivitetin "Sikur të ishim bankierë!". Studentet më të mira të Degës Financë - Bankë prezantuan para jurisë projektin e bankës së tyre të improvizuar për të financuar dy biznese të ndryshme. Anëtarët e skuadrës fituese u vlerësuan me një çmim nga Tirana Bank.



WORKSHOP MBI NDRYSHIMET NË LEGJISLACIONIN E RI TATIMOR, 19 - 20 JANAR 2015

Në kuadrin e ndryshimeve në Legjislacionin e Ri Tatimor, të cilat hynë në fuqi në janar 2015, AAB organizoi për punonjësit e bankave 2 seminare:

19.01.2015: Ndryshimet në "Ligjin Nr.9136, datë 11.09.2003 "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në RSH", i ndryshuar". Trajnimi u ndoq nga 25 pjesëmarrës të 13 bankave anëtare.

20.01.2015: "Ligji Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar". Trajnimi u ndoq nga 27 pjesëmarrës të 13 bankave anëtare.



WORKSHOP MBI NDRYSHIMET NË LIGJIN PËR SIGURIMET SHOQËRORE, 24 SHKURT 2015



Në bashkëpunim me ISSH u organizua një trajnim njëditor ku u trajtuan: Ndryshimet në ligjin nr. 7703, AAB organizoi një trajnim datë 11.05.1993, "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; përfitimet afatshkurtëra, masa e kontributeve që derdhen për këtë përfitim, procedurat dhe afatet, reforma e pensioneve, kontributet e sigurimeve shoqërore, kontributet suplementare, subjektet e detyruara për të paguar, etj. Trajnimi u ndoq nga 21 pjesëmarrës të 14 bankave anëtare.

SEMINAR MBI "PËRPUNIMIN E TË DHËNAVE PERSONALE PËR TË PUNËSUARIT NË SEKTORIN BANKAR", 4 MARS 2015

AAB, në bashkëpunim me Zyrën e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale organizoi një seminar me titull "Përpunimi i të dhënave personale për të punësuarit, në sektorin bankar". Pjesëmarrësit u informuan mbi ndryshimet e fundit në legjislacion dhe, si dhe u diskutuan probleme të ndryshme në kuadër të zbatimit të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale. Seminari u ndoq nga 25 përfaqësues të 14 bankave anëtare.



DELOITTE - SEMINAR I DEDIKUAR PËR TVSH-NË, 12 MARS 2015



Deloitte organizoi në mjediset e AAB një seminar me fokus ligjin e ri të TVSH-së në industrinë bankare. Ekspertët e Deloitte prezantuan dhe diskutuan ndryshimet në Ligj si dhe në Udhëzimin e publikuar së fundmi, duke vendosur një theks të veçantë mbi çështjen e TVSH-së për disa shërbime të cilat bankat i marrin nga jorezidentët. Përfaqësuesit e Deloitte sollën dhe shembuj nga BE.

TRAJNIM MBI "AFTËSITË DREJTUESE", 24-25 MARS DHE " AFTËSITË DHE TEKNIKAT E MBLEDHJES SË KREDIVE", 26-27 MARS 2015

AAB ka ofruar dy trajnime me partnerin e saj të ri të trajnimit SBPST.

24-25 mars: Trajnimi u kryesua nga Z. Cüneyt Erigüë, ish-bankier dhe u ndoq nga 10 pjesëmarrës të 5 bankave anëtare.

26-27 mars: Trajnimi u drejtua nga Z. Ajhan Akay, një menaxher i analizës së kredisë dhe u fokusua në bazat e mbledhjes së kredive me probleme, të cilat ëojnë në suksesin e përgjithshëm.

Trajnimi u ndoq nga 10 pjesëmarrës të 3 bankave anëtare.



TRAJNIM MBI RAPORTIN E AUDITIT, 26-27 MARS 2015



Trajnimi dy-ditor, në bashkëpunim me Institutin Shqiptar të Auditorëve të Brendshëm, u drejtua nga Z. Jean Pierre Garitte, trajnues me eksperiencë ndërkombëtare në auditin e brendshëm. Trajnimi kishte në fokus rëndësinë e organizimit të dokumenteve informative të shkruara në mënyrë të qartë dhe koncize. Trajnimi u ndoq nga 11 pjesëmarrës të 6 bankave anëtare

